

Raporti i përcjelljes së procesit të decentralizimit

Performanset e komunave
në Republikën e Maqedonisë
2008–2009

Mendimet e qytetarëve
për cilësinë e shërbimeve
të komunave
2010



PËRCJELLJA E PROCESIT
TË DECENTRALIZIMIT
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË
RAPORTI 2008-2009

Performanset e komunave
në Republikën e Maqedonisë
2008 – 2009
Mendimet e qytetarëve për cilësinë
e shërbimeve të komunave – 2010

Ky Raport është hartuar në kuadër të projektit "Vëzhgimi i implementimit të decentralizimit në Republikën e Maqedonisë 2008-2009" që financohet nga Fondacioni Instituti Shoqëria e hapur – Maqedoni (FISHM) dhe realizohet nga Qendra për zhvillimin e demokracisë lokale (QZhdL)

Shkurt, 2011

Përcjellja e procesit të decentralizimit në RM
Raport 2008-2009

Performanset e komunave në Republikën e Maqedonisë 2008-2009

Mendimet i qytetarëve për cilësinë e shërbimeve të komunave – 2010

Shkurt 2011

Boton:

Fondacioni Instituti shoqëri e hapur – Maqedoni

Për botuesin:

Vladimir Millçin, drejtor ekzekutiv

Përgatiti:

Georgi Hristov, Jane Vrteski, Natasha Iljeva – Acevska, Marina Naumovska – Milevska -
Qendra për zhvillimin e demokracisë lokale

Redaktorë:

Fani Kranfillova Panovska
Kire Milovski
Ana Medarska

Përkthimi:

Abakus

Formësimi artistik - grafik:

Brigada dizajn

Shtyp:

Bato dhe Divajn

Tirazhi:

200

Tirazh pa pagesë/ jo komercial

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR	5
KONSTATIMET KYÇE	7
Kapitulli 1: Pse vëzhgohet procesi i decentralizimit?	15
1.1 Qëllimet e hulumtimit	15
1.2 Fokusi i hulumtimit	16
Decentralizimi fiskal	16
Arsimi	16
Urbanizmi dhe planifikimi hapësinor	17
Transparenca dhe llogaridhënia	18
Kapitulli 2. METODOLOGJIA e hulumtimit	21
Kapitulli 3. Analiza e rezultateve të vijimit të procesit të decentralizimit për periudhën 2008 – 2009	45
3.1 Financat	45
3.2 Arsimi	58
3.3 Urbanizmi	73
Kapitulli 4. Zëri i qytetarëve	88
4.1 Analiza e kënaqësisë sipas fushave të injierencave	88
4.2 Analiza e kënaqësisë së përgjithshme	96
4.3 Analizat krahasuese të rezultateve të Pyetësorit	99



PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

Ky Raport përfundimtar është përgatitur në kuadër të projektit "Vëzhgimi i realizimit të decentralizimit" që e ka synuar realizimin efikas, transparent dhe të hapur të decentralizimit, përmes përcjelljes, raportimit dhe informimit publik për bartjen dhe realizimin e ingjercave në nivel lokal, në fushën e arsimit, urbanizmit dhe planifikimit urban, me përqendrim të posaçëm në decentralizimin fiskal dhe transparencën (logaridhënien) e komunave në dhënien e shërbimeve, si dhe duke u përqendruar në mendimin e qytetarëve për cilësinë e shërbimeve komunale.

Projekti financohet nga Fondacioni Instituti Shoqëria e hapur – Maqedoni (FISHM) dhe zbatohet nga Qendra për zhvillimin e demokracisë lokale (QZHDL). Në periudhën 2010-2012, ky projekt realizohet në 12 komuna-partnere¹.

Ky Raport përfundimtar i sublimon rezultatet e funksionimit të të gjitha 12 komunave-partnere në vitin 2008 dhe 2009 në fushën e arsimit, urbanizmit dhe decentralizimit fiskal, si dhe mendimet e qytetarëve për cilësinë e shërbimit të komunave, sipas hulumtimit në vitin 2010.

Qëllimi i Raportit përfundimtar është vlerësimi i realizimit të decentralizimit në përgjithësi – jo "rangimi" i komunave sipas realizimit të decentralizimit. Së këndejmi, të gjitha të dhënat dhe analizat e prezantuara kanë të bëjnë me notat/vlerësimet mesatare që janë arritur nga komunat në secilën fushë të analizuar. Analizat e ndara për komunat publikohen në dokumente të posaçme (raporte), ku

**1. Bogovinjë,
Dibër, Staro
Nagoriçane,
Kumanovë, Ohër,
Tetovë, Veles,
Karposh, Ilinden,
Strumicë, Gostivar
dhe Negotinë**

secila komunë mund t'i kontrollojë të arriturat dhe t'i krahasojë ato me vlerat mesatare të komunave-partnere të projektit.

Sipas rregullativës ekzistuese ligjore, të gjitha komunat në Republikën e Maqedonisë janë mono-tipe, gjegjësisht kanë përgjegjësi të barabartë për

përbushjen e obligimeve të bartura si përgjegjësi, pa dallim nga madhësia dhe kapaciteti i tyre (administrativ, financiar, teknik) ose parakushtet ekzistuese për përbushjen e ingjercave të bartura. Së këndejmi, analiza në një pjesë përqendrohet në analizën e realizimit të decentralizimit në komunat urbane dhe rurale të Qytetit të Shkupit. Prej 12 komunave-partnere, 3 janë komuna rurale, 8 janë urbane dhe tjetra është komunë në Qytetin e Shkupit.

Vlerësimi për realizimin e decentralizimit jepet në bazë të Indeksit të decentralizimit, që fitohet përmes Indekseve të posaçme për funksionimin e komunës – IPDA dhe IPDU (për fushën e arsimit dhe urbanizmit), si dhe Indeksit të decentralizimit fiskal (IDF). Për caktimin e këtyre indekseve për çdo fushë, aplikohet metodologjia e dizajnuar paraprakisht, sipas të cilës indekset gjegjëse fitohen sipas katër nën-indekseve adekuate, që nga ana tjetër llogariten në bazë të disa treguesve për çdo nën-indeks. Indekset, nën-indekset dhe treguesit vlerësohen sipas rëndësisë, gjegjësisht jo të gjitha prej tyre kanë rëndësi të njëjtë në përcaktimin e totalit të Indeksit të decentralizimit. Ndryshoret sasiore dhe cilësore që aplikohen gjatë llogaritjes së vlerës së treguesve, fitohen në bazë të hulumtimeve primare në të gjitha komunat-partnere, përmes plotësimit të pyetësorëve për çdo fushë, si dhe intervistave me personat përgjegjës të komunave. Nota për çdo tregues, nën-tregues dhe indeks është prej 1 deri më 5, ku nota më e lartë e tregon funksionimin më të mirë në fushën e caktuar.

Në kuadër të projektit "Vëzhgimi i realizimit të decentralizimit në Republikën e Maqedonisë 2008-2009" është realizuar edhe hulumtimi i mendimit të qytetarëve për cilësinë e shërbimeve të komunave. Gjithsej 1759 qytetarë i janë përgjigjur pyetësorit prej 53 pyetjeve, të kategorizuara në 7 fusha të ingjercave të komunave dhe 9 pyetjeve plotësuese.

Pas prezantimit të konstatimeve kyçe të të gjitha hulumtimeve të realizuara në kuadër të projektit, në Kapitullin 1 jepet pasqyra e


shkurtër e qëllimeve dhe fokusit të hulumtimit. Në Kapitullin 2 jepet përshkrimi i detajuar i metodologjive që shfrytëzohen për hulumtimet e ndryshme. Ata që interesohen vetëm për rezultatet e hulumtimit, mund të përqendrohen në Kapitullin 3, ku jepet analiza krahasuese, së bashku me analizat e detajuara të rezultateve sipas fushave, në nivel të nën-analizave dhe treguesve. Në Kapitullin 4 jepet analiza e mendimit të qytetarëve për cilësinë e shërbimeve në komuna.

2. Në llogaritjen e mesatares për IFD nuk llogaritet Ohri, meqë gjendet në fazën e parë të decentralizimit fiskal

KONSTATIMET KYÇE

Në bazë të rezultateve të fituara, përfundimi i përgjithshëm është që decentralizimi në vitin 2009 ka ngecur, në raport me vitin 2008. Konkreisht, mesatarja e indeksit të decentralizimit për 12 komunat e analizuar në vitin 2009 është më e vogël se në vitin 2008 (prej 3,11 në 3,04), si që shihet në tabelën dhe grafikun në vijim:

12 komuna			
Indeksi i performanseve	Faktori i rëndësisë	2008	2009
1. Financat	50%	2,96	2,81
2. Arsimi	25%	3,39	3,49
3. Urbanizmi	25%	3,12	3,05
Gjithsej indeksi		3,11	3,04



Zvogëlimi i nivelit mesatar në Republikën e Maqedonisë gjatë vitit 2009 është kryesisht për shkak të zvogëlimit të IFD-së² dhe IPD-së në urbanizëm, kurse IPD në arsim shënon përmirësim të vogël.

Rezultatet tregojnë që viti 2009 ka qenë më i pavoritshëm në aspekt financiar se viti 2008 për komunat. Gjithashtu, mesatarja tregon që të arriturat janë përkeqësuar edhe në urbanizëm dhe planifikim hapësinor. Funkcionim më i mirë i komunave tregohet vetëm në arsim, kryesisht për shkak të aktiviteteve që i kanë marrë komunat në nivel lokal.

Vlera e Indeksit të decentralizimit (prej 1 deri në 5) në vitin 2008 ka lëvizur mes 2,02 dhe 4,01. Në vitin 2009, kjo vlerë ka lëvizur mes 2,21 dhe 3,90. Këto të dhëna japin dy përfundime:

- Asnjë komunë e analizuar nuk e ka fituar vlerën më të ulët ose vlerën më të lartë të mundshme të Indeksit të decentralizimit (1 ose 5);
- Ndonëse ulet dallimi mes vlerës më të ulët dhe më të lartë të Indeksit në vitin 2009, ndaj vitit 2008, dallimet edhe më tej mbesin në nivel të konsiderueshëm (~98% në 2008, ~77% në 2009).

Tabela në vijim e jep analizën e rezultateve, sipas llojit të komunave (urbane, rurale dhe komunat e Qytetit të Shkupit):

Indeksi i performanseve	2008			
	Urbane	Rurale	Komunat në Shkup	Të gjitha
1. Financat	2,96	2,75	4,26	2,96
2. Arsimi	3,52	3,00	3,48	3,39
3. Urbanizmi	3,17	2,95	3,26	3,12
Gjithsej indeksi	3,15	2,86	3,82	3,11

Indeksi i performanseve	2009			
	Urbane	Rurale	Komunat në Shkup	Të gjitha
1. Financat	2,82	2,65	3,91	2,81
2. Arsimi	3,56	3,25	3,65	3,49
3. Urbanizmi	3,07	2,80	3,60	3,05
Gjithsej indeksi	3,07	2,84	3,77	3,04

Si që shihet nga tabela, pa dallim nëse flitet për komuna urbane, rurale ose komunat e Qytetit të Shkupit, ato mesatarisht tregojnë performanse më të dobëta në vitin 2009, krahasuar me decentralizimin në vitin 2008. Në dy vitet e analizuara, rezultate më të mira shënohen në komunat e Qytetit të Shkupit, ndërkohë që rezultatet më të dobëta vërehen tek komunat rurale. Këtu duhet të cekem të paktën dy fakte:

- Këto performanse më të mira të komunës në Qytetin e Shkupit, krahas komunave tjera urbane të analizuara, rezultojnë kryesisht nga notat shumë më të mira për financat. Dallimet në fushën e urbanizmit dhe arsimit janë shumë më të vogla (në vitin 2008, komunat urbane kanë treguar performanse më të mira në arsim, krahasuar me komunën e Qytetit të Shkupit);
- Ndonëse mesatarisht, komunat rurale kanë rezultate më të dobëta se ato urbane, të paktën një prej komunave rurale tregon rezultate më të mira individuale se mesatarja e komunave urbane, kryesisht për shkak të performanseve më të mira financiare.

Këto fakte dhe nota gjenerale për komunat e ndryshme në vitin 2008 dhe 2009, flasin për dy konstatime të përgjithshme:

1. Faktori më i rëndësishëm për decentralizimin fiskal është sigurimi i më tepër mjeteve financiare dhe mekanizmave për komunat. Kjo ka rëndësi të posaçme për komunat rurale, me qëllim që edhe ato të kenë mundësi t'i zbatojnë ingjierencat e dhëna me ligj.
2. Mesatarisht, komunat rurale tregojnë rezultate më të dobëta në decentralizim, krahasuar me komunat urbane.

Në kuadër të projektit është realizuar edhe hulumtimi i mendimit të qytetarëve për kënaqësinë me shërbimet e komunës. Pyetësorit i janë përgjigjur gjithsej 1.759 qytetarë. Të anketuarit i janë përgjigjur 52 pyetjeve në 7 grupe, si dhe 9 pyetjeve plotësuese.

Qytetarët e kanë vlerësuar cilësinë e secilit shërbim komunal në shkallën prej 1 deri në 5, ku 1 është shumë dobët, 2-dobët, 3-mirë, 4-shumë mirë dhe 5 është shkëlqyeshëm. Në vijim jepen konstatimet e përgjithshme, sipas notave të qytetarëve në 12 komunat e hulumtuara për çdo shërbim të caktuar komunal:

- Nota mesatare e kënaqësisë së qytetarëve prej të gjitha fushave të analizuar dhe shërbimeve që i marrin nga komuna është 2,71.
- Të gjitha shërbimet vendosen në dy nivele të shërbimit: niveli i mirë i shërbimit (mes 2,5 dhe 3,5), ku gjenden 36 shërbime komunale dhe niveli i dobët i shërbimeve (mes 1,5 dhe 2,5), ku gjenden 16 shërbime komunale.
- Asnjë shërbim i vlerësuar nuk bën pjesë në tre nivelet tjera të shërbimeve: shkëlqyeshëm, shumë mirë ose niveli shumë i dobët.

Në vijim jepen përfundimet më konkrete, në bazë të rezultateve në tre fushat e analizuar, si dhe sublimimi i kënaqësisë së qytetarëve:

FINANCAT

- **Komunat marrin pjesë me përqindje të vogël në konsumin publik, në krahasim me shtetin**

Komunat e analizuar shpenzojnë mbi 7 herë më pak të holla për kokë banori, në krahasim me shtetin. Në dy vitet e analizuar, të dalat e komunave të analizuar për kokë banori, ishin mesatarisht 14% e të dalave nga buxheti i RM-së.

- **Autonomia fiskale e komunave nuk është në nivel të lartë**

Për rreth 78% të të hyrave totale të buxheteve komunale, komunat nuk vendosin në mënyrë të mëvetëshme. Për rreth 65% të mjeteve financiare të buxheteve të tyre, komunat janë një lloj i "orientuesit", gjegjësisht vetëm i orientojnë të hollat tek institucionet gjegjëse. Më tepër se 80% e mjeteve të pranuar me transfer janë "të dedikuara", ndonëse një pjesë e madhe e tyre janë formalisht si bllok-dotacione. Në vitin 2009, të hyrat e transfereve kanë qenë 62% e totalit të buxhetit, për dallim nga viti 2008, kur transferet kanë marrë pjesë me 57%, që e tregon varshmërinë e madhe financiare nga pushteti qendror.

- **Komunat nuk kanë mjete të mjaftueshme për nevojat zhvillimore**

Mbi 85% të buxheteve të komunave të analizuar shpenzohen për shpenzime dhe të dala rjedhëse – për rroga dhe kontribute. Komunat kanë financuar 6 herë më pak mjete për investimet lokale për kokë banori, në krahasim me shtetin, kurse investimet kapitale për banor në komunat e analizuar janë zvogëluar për rreth 20% në vitin 2009, krahasuar me vitin 2008. Artikujt e shpenzimeve

zhvillimore në vitin 2009 janë zvogëluar për më shumë se 25% në llogari të artikujve operativë-administrativë. Kjo do të thotë që komunat kanë pasur më pak mjete financiare për nevoja zhvillimore.

■ Të hyrat reale të komunave janë në rënie

Ndonëse në shuma absolute shënohet rritje e të hyrave për kokë banori për vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 (prej 9.940 mkd/banor në 10.670 mkd/banor), nëse merret parasysh që inflacioni në vitin 2009 ka qenë 8,3%³, do të thotë që të hyrat reale është dashur të jenë 10.765 denarë/banor për të qenë në nivel të vitit 2008.

■ Komunat janë sjellë në mënyrë “ekonome” dhe mesatarisht, të dalat janë planifikuar në mënyrë gjegjëse dhe janë mbuluar plotësisht me të hyrat e mbledhura;

■ Decentralizimi ende nuk i ka sjellë rezultatet e barazimit dhe rumbullakosjes mes komunave

Komunat rurale kanë papunësi më të madhe dhe të hyra më të ulta për amvisëri, pastaj vijnë komunat urbane. Papunësi më të vogël dhe të hyra më të larta kanë amvisëritë në komunat e Qytetit të Shkupit.

■ Në përgjithësi, komunat i përmbushin obligimet ligjore për informimin e qytetarëve rreth planifikimit dhe realizimit të buxhetit.

3. Burimi:
Banka
Popullore e
Republikës së
Maqedonisë,
www.nbrm.mk

Të gjitha komunat e analizuara sigurojnë forma dhe mënyra për informimin e qytetarëve, me të dhënat e lidhura me buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të komunës. Në 41% të komunave të analizuara ekzistojnë procedura zyrtare (të miratuara me Vendim

të Këshillit ose Vendim të Kryetarit të komunës) për mënyrat në të cilat qytetarët njoftohen me planifikimin dhe realizimin e buxhetit komuna. Të gjitha 12 komunat kanë emëruar auditorë të brendshëm, kurse 10 prej 12 komunave i janë nënshtruar auditimit nga Enti Shtetëror për Auditim (EshA) gjatë vitit 2008 ose 2009.

ARSIMI

■ Në përgjithësi, komunat i respektojnë dispozitat ligjore dhe i realizojnë ingjerenat e lidhura me arsimin

Mbi 75% e komunave të analizuara i plotësojnë kërkesat ligjore për mbajtjen e regjistrave, kurse më shumë se gjysma mbajnë edhe regjistra dhe baza të të dhënave plotësuese.

Prej 12 komunave, vetëm njëra nuk ka emëruar përfaqësues në të gjitha këshillat shkollorë të shkollave në territorin e komunës. Vetëm disa komuna kanë praktikë të rregullt të raportimit nga mbledhjet e këshillave shkollorë, që është standard i synuar.

Masa më e rreptë e shqiptuar nga Ministria e arsimit dhe shkencës gjatë mbikëqyrjes është revokimi i ingjerenave të një komune, në pjesën e emërimit të drejtorëve gjatë vitit 2008.

■ Merren nisma për hapjen ose mbylljen e shkollave të reja fillore ose degëve të shkollave të mesme, por avancojnë shumë ngadalë drejt realizimit

Prej 12 komunave, në vitin 2008 janë ngritur 5 nisma për

racionalizimin e rjetit shkollor, prej të cilave 3 kanë pasur sukses në realizimin praktik të ndryshimeve. Në vitin 2009, 9 shkolla kanë ngritur nisma, kurse ndryshimet i kanë realizuar vetëm 3 shkolla.

Pengesë e rëndësishme gjatë realizimit të nismave është ngadalësia e përgjigjeve ndaj kërkesave të parashtruara në Ministrinë e arsimit dhe shkencës (1-3 vite).

- **Pronësia është ndërmarrë mesatarisht në 30-60% të objekteve shkollore**

Problemet kryesore kanë marrëdhëniet e parregulluara pronësore-juridike dhe të pronësisë së objekteve, si dhe evidenca e paqartë e kadastrës. Por, jo të gjitha komunat kanë bërë përpjekje maksimale për rregullimin e çështjes në fjalë;

- **Komunat investojnë pak mjete të veta në arsim**

Në përgjithësi, komunat shpenzojnë në arsim mjete në shumë të barabartë me mjetet që jepen përmes dotacioneve të pushtetit qendror. Mesatarisht, në 12 komunat, totali i shpenzimeve të arsimit është mbështetur me 9% të mjeteve vetanake gjatë vitit 2008. Në vitin 2009, kjo mesatare ka rënë në 7,8%. Për shembull, në vitin 2008 ka pasur 2 komuna që nuk kanë investuar asnjë denarë prej mjeteve vetanake, kurse shumica prej 7 komunave kanë investuar mjete vetanake në vlerë 0,1-3% nga totali i shpenzimeve për arsim.

- **Shpenzimet kapitale në arsim janë pjesë e vogël, krahasuar me totalin e shpenzimeve kapitale në komuna.**

Në vitin 2008, pjesëmarrja mesatare e të dalave kapitale

për arsim në totalin e të dalave kapitale të komunës ka qenë 2,1% (në 5 komuna nuk ka pasur asnjë investim kapital në arsim). Ky numër është rritur në 4,2% gjatë vitit 2009 (3 komuna nuk kanë pasur investime kapitale).

- **Pushteti qendror nuk ka mbështetur investime kapitale në arsim përmes buxhetit qendror, por direkt prej nivelit qendror në shkolla. Kjo ndodh te pjesa më e madhe e komunave.**

Në vitin 2008 dhe 2009, vetëm tre komuna janë shprehur që kanë marrë mjete nga niveli qendror për investime kapitale në arsim. Gjendja tregon që pushteti qendror nuk e respekton Ligjin për financim të njëjësive të vetëqeverisjes lokale.

- **Me bartjen e ingjercës, shfaqet dukuri pozitive e komunave të angazhojnë kuadër plotësues mësimdhënës, që financohet me mjete të komunës**

Prej grupit tonë të 12 komunave, gjatë vitit 2008, 4 komuna kanë financuar forcë plotësuese të punës në arsim. E njëjta ka ndodhur edhe në vitin 2009.

- **Mesatarisht, komunat rrallë herë e respektojnë obligimin ligjor për miratimin e Vendimit (të Këshillit komunal) për masat dhe kriteret e shpërndarjes së mjeteve të bllok-dotacioneve mes shkollave në territorin e komunës**

Ekzistimi i këtij vendimi do të thotë se ekziston mundësia e parashikimit, objektivitetit dhe transparencës gjatë shpërndarjes së mjeteve për shkollat. Gjithsesi, kjo është një prej gjërave që duhet të ndodhë edhe në nivel lokal.

Rrallë herë, analizat e gjendjes financiare dhe nevojave

të shkollave bëhen në mënyrë të pasistemuar dhe papërputhshme. E njëjta ndodh edhe gjatë hartimit të elaborateve dhe planeve për racionalizimin e shpenzimeve në shkolla.

- Në përgjithësi, komunat janë të njohura me Normativet dhe standardet për hapësirën dhe pajisjen mësimore dhe kanë realizuar incizime të caktuara të gjendjes.
- Komunat e organizojnë me sukses transportin pa pagesë të nxënësve dhe ngrohjen e shkollave .
- Komunat nuk kanë qasje strategjike ndaj zhvillimit të arsimit

Në përgjithësi, komunat nuk hartojnë strategji të posaçme për zhvillimin e arsimit dhe shumë rrallë buxhetojnë projekte strategjike në fushën e arsimit. 5 komuna (41,6%) nuk kanë asnjë lloj të strategjisë arsimore, nuk i parashohin me buxhet projektet strategjike për arsimin dhe nuk i marrin parasysh rezultatet e vetë-vlerësimit të shkollave.

- Komunat më së shpeshti shfrytëzojnë katër forma të ndryshme për informimin e qytetarëve për arsimin

Më së shpeshti aplikohet format në vijim: Tabela informative, gazeta zyrtare, internet-faqet dhe mediat lokale. Raportet financiare të shkollave publikohen në gazetën zyrtare të komunës. Në disa komuna organizohen takime mes udhëheqësisë komunale dhe përfaqësuesve të këshillave shkollorë. Më shpesh organizohen takime me asociacionet e qytetarëve në temat e lidhura me arsimin.

URBANIZMI

- Komunat kanë nivel të ulët të lirisë në zbatimin e ingjerençave

Të gjitha komunat e analizuar konsiderojnë që duhet të kenë më shumë liri, krahas pushtetit qendror në zbatimin e ingjerençave. Kjo vjen si pasojë e ndikimit të pushtetit qendror mbi zbatimin e kësaj ingjerençe, në pajtim me rregullativën ekzistuese ligjore, sipas të cilës NJML-të obligohen të kërkojnë dhe marrin pëlqim për dokumentacionin urbanistik ose për pjesën e aktiviteteve që lidhen me planifikimin urban, nga ana e ministrive kompetente dhe agjencive shtetërore.

- Komunat nuk janë në gjendje ta zbatojnë plotësisht ingjerençën (p.sh. gjatë hartimit dhe realizimit të planeve urbane) për shkak të nivelit të ulët të decentralizimit fiskal dhe mjeteve të pamjaftueshme për nevojat zhvillimore

Në masën më të madhe, rreth 70% e komunave e financojnë vetëm hartimin e planeve urbane. Të gjitha komunat kanë nevoja të padyshimta për rritjen e sipërfaqes që duhet të përfshihet me plane urbane. Arsyeja për të cilën nuk ka mbulim të plotë të territorit komunal me plan urban është niveli i ulët i kapaciteteve fiskale të komunave për realizimin e planeve urbane, si dhe mungesa e mjeteve për nevoja zhvillimore.

- Komunat nuk i realizojnë tërësisht ingjerençat e tyre në pjesën e inspektimit urban dhe ndërtimor

Komunat nuk kanë planifikuar mjete të mjaftueshme për realizimin e vendimeve të miratuara për rrënimin e objekteve pa leje. Madje, në përgjithësi, nuk i kanë edhe realizuar mjetet e parapara për këtë qëllim. Sipas të dhënave të realizuara, në komunat e analizuara janë realizuar vetëm rreth 20% e vendimeve të miratuara për rrënimin e objekteve të ndërtuara pa leje. Kjo mund të shpjegohet me pritjen e miratimit të ligjit, me të cilin do të rregullohet statusi i objekteve të ndërtuara pa leje.

- **Është rritur përqindja e efikasitetit dhe efektivitetit të komunave në lëshimin e shërbimeve të ndryshme nga fusha e ingjercës**

Komunat e analizuara kanë përqindje të madhe të efikasitetit, rreth 90% në lëshimin e vendimeve dhe lejeve më të rëndësishme në fushën e urbanizmit dhe planifikimit urban, si për shembull: ekstrakti i planit urban, vendimi për kushtet e lokacionit, leja e ndërtimit, leja për shfrytëzim.

- **Komunat kanë filluar me aplikimin e veglave të sofistikuar për implementimin e ingjercës, por ende nuk kanë arritur kapacitete të konsiderueshme për implementimin e ingjercës me aplikimin e të arriturave të reja teknologjike**

Analiza ka treguar që komunat janë inovative në implementimin e ingjercës, që shihet përmes shfrytëzimit të internetit dhe GIS teknologjisë, si dhe përmes posedimit të burimeve gjegjëse njerëzore që mund t'i shfrytëzojnë teknologjitë e reja. Por, edhe më tej nuk kanë arritur kapacitete domethënëse për implementimin e ingjercës me aplikimin e të arriturave të reja teknologjike.

- **Komunat kanë sistem të mirë për mbledhjen e informatave kthyesë nga qytetarët dhe format e organizuara të pjesëmarrjes qytetare në procedurat për miratimin e planeve urbane**

Sipas të dhënave të analizuara, komunat shfrytëzojnë metoda të ndryshme për dorëzimin dhe mbledhjen e informatave nga qytetarët dhe formave të organizuara të pjesëmarrjes qytetare në procedurat e sjelljes së planeve urbane. Janë transparente në lejin e qasjes ndaj informatave të karakterit publik.

ZËRI I QYTETARËVE

- **Nota mesatare e kënaqësisë së qytetarëve për të gjitha fushat e analizuara dhe shërbimet që i marrin nga komuna është 2,71.**
- **Prej shërbimeve të ndara, të anketuarit i kanë dhënë notë më të lartë arsimit fillor (3,45), kurse nota më e dobët i është dhënë shërbimit të lidhur me shtëpitë e bonjakëve**

Mes dhjetë shërbimeve me rangim më të lartë, gjendet edhe nota gjenerale për arsimin e mesëm, cilësia dhe profesionaliteti i kuadrit mësimdhënës, furnizimi me ujë dhe ujësjellësi, transporti i nxënësve, menaxhimi me mbeturinat, ndriçimi publik rugor, kopshtet dhe kujdesi për fëmijët, rregullimi urban komunal dhe mbrojtja kundër zjarrit.

Në dhjetë shërbimeve me nota më të dobëta gjenden: entet për personat e varur nga alkooli dhe droga, menaxhimi me kafshët e rugës, aktivitetet për ritjen e punësimit, azilet e

personave të moshuar, njohja me qytetarët për shpenzimin e buxhetit komunal, menaxhimi me korrupsionin, pjesëmarrja e qytetarëve dhe biznesit në hartimin e dokumenteve strategjike komunale për zhvillim, promovimi i kushteve për zhvillim të industrisë dhe pjesëmarrja e qytetarëve në marrjen e vendimeve strategjike me rëndësi lokale.

- Analizuar sipas fushave, më së miri vlerësohen shërbimet që janë pjesë e **fushës së Arsimit, kulturës, sportit dhe rekreacionit (3,10)**, kurse më së dobëti vlerësohen shërbimet e fushës së **Mbrojtjes sociale (2,31)**
- Në fushën e **Arsimit, kulturës, sportit dhe rekreacionit (3,10)**, nota më të larta gjenerale ka arsimit fillor (3,45) dhe i mesëm (3,44), kurse notë më të dobët në këtë fushë ka ushqimi i nxënësve (2,72).
- Në fushën e **Urbanizmit dhe planifikimit urban (2,80)** notë më të lartë ka rregullimi urban i komunës (3,15), kurse notë më të ulët ka planifikimi urban në mjediset rurale (2,58), së bashku me transparencën në procedurat për shpërndarjen e tokave (2,60).
- Në fushën e **Zhvillimit ekonomik lokal (2,32)** notë më të lartë ka promovimi i kushteve për zhvillimin e ndërmarjeve të vogla dhe të mesme (NVM) me 2,52, kurse më se keqj notohen aktivitetet për ritjen e punësimit (2,07).
- Fusha e **Mbrojtjes sociale (2,31)** në përgjithësi ka qenë me vlerësim më të ulët prej të gjitha fushave të hulumtuara. Në kuadër të fushës, notë më të madhe krahas shërbimeve tjera kanë kopshtet dhe kujdesi për fëmijë (3,28). Nota më të këqija në këtë fushë kanë marrë shërbimet e lidhura me shtëpitë e bonjakëve (1,73) dhe

entet për personat e varur nga alkooli dhe droga (1,78). Përgjigjet tregojnë që shoqëria maqedonase është e papërgjegjshme për personat që kanë më së shumti nevojë për ndihmë: bonjakët, personat e varur nga alkooli, personat e varur nga droga, personat në moshë. Nevojitet përmirësimi dhe rritja e qasjes së shërbimeve komunale për këto kategori të qytetarëve.

- Në kuadër të fushës së **Vepimitarive komunale (2,90)** nota më të larta kanë shërbimet e menaxhimit me mbeturina (3,36), furnizimit me ujë, kanalizimit (3,30) dhe ndriçimit publik rrugor (3,29). Nota më të ulëta në këtë fushë kanë shërbimet e lidhura me menaxhimin e kafshëve të rrugës (1,94).
- Në fushën e **Demokracisë, transparencës dhe llogaridhënies në punë (2,53)**, notë më të madhe ka qasja ndaj informatave komunale (2,91), kurse nota më e dobët i është dhënë ballafaqimit me korrupsionin (2,19).
- Në fushën e **Mbrojtjes**, notë më të mirë ka mbrojtja kundër zjarrit (3,10), kurse notë më të dobët mbrojtja dhe shpëtimi në kushte të krizës (2,68).
- Analiza krahasuese e rezultateve sipas demografisë të të anketuarve ka treguar që:
 - Femrat e anketuara janë më të kënaqura se meshkujt e anketuar. Edhe femrat edhe meshkujt kanë dhënë vlerësim më të lartë për fushën e arsimit, kulturës, sportit dhe rekreacionit. Nota më të ulëta i janë dhënë fushës së **Mbrojtjes sociale**.
 - Edhe të anketuarit e kategorive të ndryshme të moshës i japin nota më të larta fushës së **Arsimit, kulturës, sportit dhe rekreacionit**. Nga ana

tjetër, të anketuarit e grupeve të moshës (18-25 dhe 46-65) japin nota më të këqija për fushën e Mbrojtjes sociale. Të anketuarit e moshës 26-45 dhe mbi 45 vjeç, kanë dhënë nota më të këqija për fushën e **Zhvillimit ekonomik lokal**.

- Të anketuarit e rretheve urbane dhe rurale kanë dhënë nota më të larta për fushën e **arsimit, kulturës, sportit dhe rekreacionit**. Të hulumtuarit e rretheve urbane kanë dhënë nota më të këqija për fushën e **zhvillimit ekonomik lokal** – ata të rretheve lokale për fushën e **mbrojtjes sociale**.
 - Të anketuarit e të gjitha bashkësive etnike, së bashku kanë dhënë vlerësim më të lartë për fushën e **Arsimit, kulturës, sportit dhe rekreacionit**. Të hulumtuarit e mjediseve urbane i kanë dhënë notë më të ulët fushës së **Zhvillimit ekonomik lokal**, kurse ata të mjediseve rurale – **Mbrojtjes sociale**.
 - Të anketuarit e të gjitha bashkësive etnike, së bashku kanë dhënë vlerësim më të lartë për fushën e **Arsimit, kulturës, sportit dhe rekreacionit** dhe notë më të ulët për fushën e **Mbrojtjes sociale**.
- Rreth gjysma e qytetarëve të anketuar rrallë herë ose aspak nuk bëjnë dallim mes shërbimeve që i jep pushteti qendror dhe shërbimeve të pushtetit lokal.
 - Mbi 2/3 e të anketuarve konsiderojnë që procedurat e fushës së urbanizmit janë përmirësuar ose të paktën kanë mbetur të njëjta gjatë periudhës kur komuna është përgjegjëse për shërbimet në fjalë (prej vitit 2005).

- Rreth 80% e të anketuarve besojnë që në përgjithësi, menaxhimi me shkollat është përmirësuar ose të paktën është e njëjtë në periudhën kur komuna është përgjegjëse për shërbimet në fjalë (prej vitit 2005).
- Ndonëse qytetarët kanë dhënë nota të ulëta për shërbimet e fushës së zhvillimit lokal, mbi 80% e qytetarëve konsiderojnë që zhvillimi lokal i komunës është rritur ose është i njëjtë prej vitit 2005.
- Në aspekt të çmimeve për furnizimin me ujë dhe kanalizim, numri është pothuajse i barabartë i atyre që mendojnë se çmimet janë normale/të pranueshme ose të larta.
- Rreth gjysma e të anketuarve konsiderojnë se çmimet për mbeturina dhe higjienë publike janë normale/të pranueshme. Megjithatë, 1/3 e të anketuarve besojnë se këto çmime edhe më tej janë të larta.
- 40% e të anketuarve ka gjasa ta rekomandojë komunën si vend i mirë për jetë, kurse 24% do ta rekomandojë me siguri. 19% nuk do ta rekomandojë, kurse 5% e të anketuarve definitivisht nuk do ta rekomandojë komunën si vend të mirë për jetë.

KAPITULLI 1: PSE VËZHGOHET PROCESI I DECENTRALIZIMIT?

1.1 Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi kryesor i hulumtimit është dhënia e kontributit drejt realizimit të procesit efikas, transparent dhe të hapur të implementimit të demokracisë në Republikën e Maqedonisë. Kjo arrihet përmes përcjelljes, analizës dhe informimit publik për bartjen dhe zbatimin e ingjercave në nivel lokal, në fushën e autonomisë fiskale, arsimit, urbanizmit dhe planifikimit urban, me fokus të posaçëm në transparencën dhe llogaridhënien e komunave.

Qëllimi i vëzhgimit të realizuar dhe qëllimi i këtij raporti është të vlerësohet implementimi i decentralizimit, si dhe të jepen përfundime që do të jenë të dhëna të dobishme për punën e mëtejshme të pushtetit lokal dhe atij qendror. Konstatimet e kësaj analize japin udhëzime për zgjerimin e praktikave të mira, si dhe për përmirësimin e dukurive negative, që do të rezultojë me rritjen e efikasitetit të zbatimit të procesit gjeneral.

Vëzhgimi në asnjë rast nuk e synon "rangimin" e komunave sipas zbatimit të decentralizimit. Për këtë arsye, të dhënat dhe analizat e prezantuara lidhen me vlera/nota mesatare, që janë arritur nga komunat-partnere në fushat e analizuara. Analizat individuale për komunat janë hartuar në dokumente të posaçme (Raporte), ku secila komunë mund t'i shohë të dhënat për vete dhe t'i krahasojë të arriturat me vlerat mesatare të komunave-partnere të projektit.

Përveç kësaj, hulumtimi ka edhe një qëllim tjetër të rëndësishëm – të "incizohet" percepticioni i qytetarëve për cilësinë e shërbimeve të komunës. Ky hulumtim mund të shërbejë për krijimin e indeksit të kënaqësisë qytetare me shërbimet, me të cilin mund të matet realizimi i shërbimeve komunale. I njëjti mund të shfrytëzohet

edhe si input i rëndësishëm në proceset e planifikimit strategjik të zhvillimit ekonomik lokal, si dhe të ndihmojë në krijimin e kulturës së udhëheqjes së komunës, në bazë të "orientimit drejt qytetarëve". Kjo do të sigurojë mundësi për sjelljen e vendimeve të informuara nga kryetarët e komunave dhe këshillat komunalë, ku do të ngërthehen prioritetet e ndryshueshme dhe qëndrimet e qytetarëve.

1.2 Fokusi i hulumtimit

Decentralizimi fiskal

Me reformën e sistemit të vetëqeverisjes lokale, sistemi i ri i financave publike lokale duhet ta sigurojë edhe autonominë e komunave dhe të drejtën e udhëheqjes së politikës së mëvetësishme në kornizat e ingjercave, përveç sigurimit të objektivitetit, transparencës, stabilitetit dhe barazisë. Në fakt, zhvillimi i vetëqeverisjes lokale vlerësohet sipas nivelit të pjesëmarrjes së shpenzimeve komunale në totalin e shpenzimeve publike, si dhe përmes përqindjes me të cilën shpenzimet lokale publike marrin pjesë në bruto-prodhimin vendor. Përqindja me të cilën burimet vetanake të të hyrave marrin pjesë në totalin e të hyrave komunale ka rëndësi të posaçme, meqë autoritetet lokale kanë të drejtë diskrecioni për të vendosur për shpenzimin e tyre. Sa më e lartë të jetë pjesëmarrja e burimeve vetanake të të hyrave, aq më autonome dhe më e pavarur është qeverisja lokale, meqë varet më pak nga transferet e pushtetit qendror.

Një prej përkushtimeve themelore të Nenit 9 të Kartës evropiane të Këshillit të Evropës për vetëqeverisje lokale është që burimet e mjeteve duhet të jenë në nivel adekuat me ingjercat e reja. Një pjesë e burimeve duhet të rrjedhë nga taksat dhe kompensimet lokale dhe ata duhet ta caktojnë vetëm nivelin dhe burimet e mjeteve, në kornizat ligjore dhe duke qenë të mjaftueshme, shumëllojshme dhe elastike.

Në aspekt të të hyrave të njërive të vetëqeverisjes lokale, për decentralizim efikas të ingjercave duhet të sigurohen disa kriterë themelore:

- Burime të mjaftueshme të pushteteve lokale për ushtrimin e ingjercave të dhëna me ligj;
- Shpërndarja e të hyrave duhet të sigurojë nivel të caktuar të autonomisë në mbledhjen e të hyrave nga pushtetet lokale;
- Sistemi i mirëfilltë i tatimeve lokale që siguron lidhje mes komunës dhe fushës ku shërbimet financohen përmes këtij tatimi;
- Dizajni i mekanizmit të transfereve dhe metodologjive për shpërndarjen e mjeteve duhet të bazohen në parime të shëndosha ekonomike, pa dallim që janë zgjedhje politike.

Arsimi

Decentralizimi i ka sjellë ingjercat të reja komunave në fushën e arsimit. Rregullimi themelor bëhet me Ligjin për vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e RM nr. 05/2002), ku neni 22, paragrafi 1, pika 8 e jep përkufizimin në vijim: **“themelimi, financimi dhe administrimi i shkollave fillore dhe të mesme, në pajtim me ligjin, organizimi i transportit dhe ushqimit të nxënësve, si dhe vendosja e tyre në konviktet e nxënësve”**.

Në pajtim me ingjercën e definuar, në vitin 2004, Ministria e arsimit dhe shkencës e ka miratuar Strategjinë për decentralizim të arsimit, që ka qenë bazë për ndryshimet e mëvonshme të Ligjit për arsim fillor dhe të mesëm. Kjo strategji ka paraparë që decentralizimi i arsimit ta vijojë modelin e decentralizimit fiskal, të përcaktuar me Ligjin për financimin e komunave. Decentralizimi do të realizohet në dy faza:

- **Faza e parë:** zgjedhja lokale e drejtorëve të shkollave dhe roli i shtuar i këshillave shkollorë. Bartja e pronësisë së objekteve shkollore dhe ingerencës për mirëmbajtjen e objekteve, si dhe organizimi i transportit të nxënësve. Në vijim të kësaj, komuna merr dotacione të dedikuara në fazën e parë, për mirëmbajtjen e shkollave dhe transportin e nxënësve.
- **Faza e dytë:** bartja e të punësuarve të sektorit të arsimit nga niveli qendror në nivel lokal, si dhe bartja e ingerencave mbi standardin e nxënësve dhe pronësinë e konvikteve studentore. Në fazën e dytë, komuna merr blok-dotacione për arsimin, që i përshijnë edhe mjetet e rrogave të të punësuarve në shkolla.

Ndryshimet më të rëndësishme të realizuara me decentralizimin e arsimit fillor dhe të mesëm janë:

- Komuna është shndërruar në themelues të shkollave dhe tani është përgjegjëse për hapjen dhe mbylljen e shkollave, si dhe për rregullimin e rjetit shkollor në territorin e komunës, sipas pëlqimit të pranuar nga Ministria e arsimit dhe shkencës (MASH);
- Komuna është bërë pronare e objekteve shkollore dhe ka marrë përgjegjësi për planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve për sigurimin e kushteve sa më të mira për punën e shkollave, si dhe për kujdesin e gjendjes së mirë të objekteve shkollore;
- Drejtori i shkollës tani zgjedhet nga Këshilli shkollor dhe emërohet nga Kryetari i komunës, që e rrit autonominë e shkollës;

- Komuna vendos vetë për mënyrën e shpërndarjes së mjeteve mes shkollave në territorin e komunës (me përjashtim të rrogave të të punësuarve), në bazë të masave dhe kriterëve të përcaktuara në nivel lokal;
- Komuna mund të investojë mjete plotësuese në sistemin e vet lokal, si plotësim ndaj transfereve të pushtetit qendror (përveç rrogave të të punësuarve);
- Komuna e planifikon dhe realizon transportin e atyre nxënësve që kanë të drejtë ligjore për transport falas;
- Komuna merr pjesë në hapjen dhe mbylljen e drejtimeve të arsimit profesional, në pajtim me nevojat e ekonomisë lokale dhe zhvillimit ekonomik, pas pëlqimit të dhënë nga MASH.

Urbanizmi dhe planifikimi hapësor

Praktikat e menaxhmentit komunal janë në zhvillim e sipër dhe në komunat e Maqedonisë nuk ekziston sistem i definuar qartë dhe i integruar për planifikimin e zhvillimit në tërësi, ku planet urbane në tërësi do ta përcjellin sistemin për zhvillim mbarëpërfshirës të komunës. Neni 22 i Ligjit për vetëqeverisje lokale⁴ parasheh që komunat të jenë përgjegjëse për planifikimin urban dhe rural, si dhe për planifikimin e zhvillimit ekonomik lokal.

Ligji për buxhete i vitit 2005⁵ e jep kornizën e buxhetimit të komunave, kurse neni 15 i këtij Ligji e promovon idenë e planifikimit strategjik trevjeçar. Ligji për planifikim hapësor dhe urbanistik i vitit 2005⁶ e jep kornizën e planifikimit hapësor dhe planifikimeve të llojeve tjera të planifikimit urban komunal. Planifikimi hapësor duhet ta mbulojë territorin e Republikës, por mund të bëhet edhe plani specifik hapësor i

4. Ligji për vetëqeverisje lokale, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 5/02

5. Ligji për buxhete, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 64/05

6. Ligji për planifikim hapësor dhe urban, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 24/08

rajonit të caktuar ose për ndonjë fushë me interesit të posaçëm të shtetit.

Në përgjithësi, ekzistojnë katër lloje të planeve urbanistike:

- Planet gjenerale urbanistike (PgjU)
- Planet e detajuara urbanistike (PDU)
- Planet urbane për vendet e banuara
- Planet urbane për zonat jashtë vendeve të banuara

Përveç planifikimit urbanistik, ligjvënësi nuk e ka precizuar sistemin e planifikimit të zhvillimeve të komunave. Kjo do të thotë që komunat kanë liri të zhvillimit të sistemit të tyre, që në esencë është gjë e mirë, për shkak se ato dallojnë njëra prej tjetrës. Bazat e tyre fillestare dhe nevojat për planifikim dallojnë, e njëjta ndodh edhe me kapacitetet e tyre për planifikim.

Transparenca dhe llogaridhënia

Pushteti transparent bazohet në të dhëna dhe informata të hapura, procedura të qarta për vendim-marrje pjesëmarrëse, si dhe procedura dhe afate të qarta për dhënie e shërbimeve publike. Llogaridhënia është niveli në të cilin pushtetet lokale e shpjegojnë dhe arsyetojnë atë që kanë arritur ose nuk kanë arritur ta bëjnë me të hollat publike, të cilat i kanë në dispozicion. Aspekti i tretë kyç i qeverisjes së mirë është pjesëmarrja e qytetarëve në vendim-marrjet me rëndësi publike komunale. Nevoja e llogaridhënies para qytetarëve e përforcon presionin për transparencë më të madhe të pushtetit lokal, ku pjesëmarrja qytetare do të jetë masë dhe vërtetim për llogaridhënie dhe transparencë.

Standardet që lidhen me transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në nivel lokal, bazohen në disa dokumente: Ligji për vetëqeverisje lokale, Ligji për qasje të lirë ndaj informatave të karakterit publik, Kodi etik i funksionarëve lokalë të Republikës së Maqedonisë, Kodi etik i nëpunësve shtetërorë, Ligji për parandalimin e korrupsionit, etj.

Kështu, për shembull, Ligji për vetëqeverisje lokale përmban mjaft pjesë me të cilat rregullohet transparenca e punës së komunave, si dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendim-marrjen e vendimeve të rëndësishme në nivel lokal:

- I obligon komunat që me statutin e tyre t'i rregullojnë mënyrat e informimit publik për punën e tyre, mënyrat dhe rastet kur organizohen tribunat publike, anketat dhe propozimet e qytetarëve, por edhe procedurat për dorëzimin e ankesave dhe propozimeve për punën e organeve komunale (Neni 7);
- I obligon kryetarët e komunave dhe administratat që pa kompensim t'i informojnë qytetarët për punën e komunës, planet dhe aktivitetet e rëndësishme për zhvillimin komunal (planet zhvillimore, strategjitë, etj). Gjithashtu, administrata obligohet të sigurojë qasje tek informatat e lidhura me shërbimet që ia sigurojnë qytetarëve (Neni 8);
- I definon format e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendim-marrje për çështjet e rëndësishme lokale: iniciativat qytetare, tubimet e qytetarëve dhe referendumet, si dhe ankesat dhe propozimet e qytetarëve, anketat, tribunat, etj. Ligji parasheh që shpenzimet për realizimin e pjesëmarrjes së qytetarëve duhet të mbulohen nga buxheti i komunës (Neni 25).

Ligji për qasje të lirë ndaj informatave të karakterit publik i vitit 2006, në esencë parasheh që çdo person ka mundësi të kërkojë çfarëdo informate të karakterit publik, nga cilido pushtet publik/institucion. Në fund, një prej parimeve të Kodit etik të funksionarëve lokalë është "përgjegjësia dhe llogaridhënia para qytetarëve". Sipas këtij parimi, funksionari përgjigjet kryesisht dhe në radhë të parë para qytetarëve, për arsye se është zgjedhur ose emëruar në emër të tyre.



KAPITULLI 2. METODOLOGJIA E HULLUMTIMIT

2.1 Modeli shumëdimensional metodologjik dhe objektiviteti

Për të vlerësuar nëse decentralizimi i jep rezultatet e dëshiruara, duhet të caktohen mënyra për matjen e efekteve të implementimit të decentralizimit. Duke e marrë parasysh faktin që kjo fushë është shumëdimensionale dhe komplekse, ajo nuk mund të vështrohet në mënyrë direkte, as nuk mund të matet si proces i vetëm. Por, mund të vëzhgohen shumë aspekte individuale të këtij procesi, që në fund mund ta lejojë vlerësimin e efekteve të decentralizimit në jetën e qytetarëve dhe zhvillimin mbarëpërfshirës të shoqërisë.

Përcjellja e realizimit të procesit të decentralizimit ngërthen sfidë të madhe metodologjike, në radhë të parë për shkak se kjo fushë është shumëdimensionale dhe komplekse, që nuk mund të matet si proces i vetëm. Në procesin e decentralizimit bashkohen dhe ndeshen faktorë të ndryshëm të nivele të ndryshme: shumica e faktorëve i takojnë nivelit lokal (administrata komunale), por shumë gjëra edhe më tej varen nga rregullimi i sistemit të përgjithshëm (niveli qendror). Në të njëjtën kohë duhet të merren parasysh edhe qytetarët dhe kënaqësia me shërbimet, si shfrytëzues të fundit të shërbimeve komunale.

Metodologjia është e dizajnuar për t'i përfshirë të gjitha fushat e cekura të decentralizimit:

- ajo përfshin tre fusha të decentralizimit: autonominë fiskale, arsimin dhe urbanizmin dhe planifikimin urbanistik;
- janë matur mbi 50 tregues që janë bashkim i treguesve

kritik të performansave të nivelit lokal, ku një pjesë e tyre i sendërtojnë edhe ndikimet e nivelit qendror të pushtetit;

- treguesit janë të grupuar për t'i pasqyruar katër dimensionet kyçe për realizimin e decentralizimit në çdo fushë, gjegjësisht: niveli i respektimit të politikave, gjendja financiare, shërbimet që i marrin qytetarët, transparencja dhe llogaridhënia;
- është realizuar matja e perceptcionit të qytetarëve për shërbimet komunale.

Objektiviteti është parim i rëndësishëm metodologjik i këtij vëzhgimi. Për arritjen e nivelit maksimal të objektivitetit të këtij hulumtimi, janë ndërmarrë hapat në vijim::

- Të dhënat primare janë mbledhur përmes hulumtimit në terren në 12 komunat-partnere⁷;
- Hulumtimi në terren është përbërë nga kombinimi i intervistave të strukturuar me anëtarët kyçë të administratave komunale në çdo fushë, si dhe nga plotësimi i pyetësorëve për secilën fushë të testuar;
- Është realizuar anketimi i kryetarëve të komunave dhe të gjithë administratorëve tjerë të intervistuar, për përcaktimin e faktorëve me pesha të ndryshme, që janë aplikuar për llogaritjen e indekseve;

**7. Bogovinjë,
Dibër, Staro
Nagoriçane,
Kumanovë, Ohër,
Tetovë, Veles,
Karposh, Ilinden,
Strumicë, Gostivar
dhe Negotinë**


- Një pjesë e madhe e të dhënave që janë kërkuar përmes pyetësorëve – veçanërisht në pjesën e financave lokale, janë të dhëna zyrtare të publikuara në llogarinë përfundimtare dhe raportet tjera financiar të komunave.

- Janë shfrytëzuar edhe burimet plotësuese të të dhënave: rregullativat juridike, gazetatat zyrtare të komunave, treguesit dhe analizat statistikore, etj;
- Vlera e treguesve është vlerësuar në bazë të kriterëve të definuara sipas standardeve ligjore ose vlerave mesatare për gjendjen e konstatuar;
- Janë përcaktuar indekse dhe nën-indekse për realizimin e decentralizimit në çdo komunë dhe çdo fushë, që llogariten sipas formulave ekzakte matematikore dhe që rezultojnë me notë matematikore për nivelit e performanseve të komunave në fushat e caktuara;
- Hulumtimi i mendimit të qytetarëve është plotësim i hulumtimit në terren, të realizuar nga administratat komunale, me qëllim që të fitohet pasqyra më e plotë e nivelit të realizimit të decentralizimit.

2.2 Qasja metodologjike e hulumtimit

Vëzhgimi i realizimit të decentralizimit të ingerencave të analizuarra e vijon modelin e shfaqur në Grafikon 1 dhe bazohet në qasje mbarëpërfshirëse, ku merren parasysh: 1) politikat nacionale përmes të cilave realizohet ingerenca; 2) pavarësia financiare dhe kapaciteti i komunës për implementimin e ingerencës; 3) performanset e komunës gjatë realizimit të shërbimeve të ingerencës së caktuar dhe 4) nivelin e transparencës dhe llogaridhënies së komunës në implementimin e ingerencës së caktuar.

Grafiku 1: Modeli për vëzhgimin e realizimit të decentralizimit



Modeli i këtillë i vëzhgimit të decentralizimit e përfshin të cekurën në vijim:

- 1) Krijimin dhe matjen e indeksit të decentralizimit fiskal (IDF) të komunës;
- 2) Krijimin dhe matjen e performanseve të decentralizimit (IPD) për ingerencat konkrete – **arsim dhe urbanizëm dhe planifikimi hapësinor**;
- 3) Matja e kënaqësisë së qytetarëve nga cilësia e shërbimeve të ofruara nga komunat.


Qasja metodologjike për llogaritjen e IDF-së për secilën komunë në fushat e analizuarra, në vete e përfshin edhe definimin dhe llogaritjen e vlerave të katër nën-indekseve (Figura 2):

1. **Nën-indeksi i implementimit të politikave fiskale** – formohet prej treguesve që lidhen me implementimin e politikave nacionale fiskale për decentralizimin në çdo komunë;
2. **Nën-indeksi i gjendjes financiare të komunave** – formohet prej treguesve që lidhen me gjendjen financiare të njësisë së vetëqeverisjes lokale, gjegjësisht të hyrave dhe të dalave të buxhetit komunal;
3. **Nën-indeksi i gjendjes së përgjithshme ekonomike të komunave** – formohet prej treguesve që lidhen me gjendjen e përgjithshme ekonomike në komunë dhe mbi të cilat jo çdoherë ndikon puna e njësisë së vetëqeverisjes lokale (për shembull: niveli i punësimit, papunësisë, të ardhurat për amvisëri, etj);


4. **Nën-indeksi i transparencës dhe llogaridhënies në punën financiare të komunave** – formohet prej treguesve që lidhen me transparencën dhe llogaridhënien e pushteteve lokale për mënyrat në të cilat i informojnë dhe konsultojnë qytetarët mbi mbledhjen dhe shpenzimin e të hollave të buxhetit komunal.

Qasja për llogaritjen e IPD-së është identike me qasjen për llogaritjen e IDF-së, me dallime të vogla gjatë definimit të katër nën-indekseve, që në rastin e performanseve të komunave janë (Grafiku 3):

Grafiku 2: Qasja metodologjike për llogaritjen e IDF-së



Grafiku 3: Qasja metodologjike për llogaritjen e IPD-së



1. Nën-indeksi i implementimit të politikave të decentralizimit – formohet prej treguesve përmes të cilëve bëhet vlerësimi për masën e implementimit të politikave nacionale dhe/ose kontributit të tyre për decentralizimin e suksesshëm;
2. Nën-indeksi i gjendjes financiare të komunës – formohet prej treguesve që lidhen me ndikimin që e ka aftësia financiare e komunës për realizimin e ingjercës konkrete;
3. Nën-indeksi i performanseve të shërbimeve komunale – formohet prej treguesve që lidhen me performanset e shërbimeve që jepen nga komuna për ingjercën e caktuar;
4. Nën-indeksi i transparencës dhe llogaridhënies – formohet prej treguesve që lidhen me transparencën e pushtetit lokal në realizimin e ingjercës së caktuar;

Grafiku 2 dhe 3 e jep pasqyrën grafike të sistemit të vëzhgimit, që i përfshin ndryshoret/të dhënat, treguesit, nën-indeksit, indeksin për performanset e decentralizimit (IPD) në fushën e arsimit dhe urbanizmit, indeksin e decentralizimit fiskal, si dhe mënyrën e lidhjes së tyre logjike.

IPD dhe IDF i dizajnuar në këtë mënyrë japin indikacion për masën dhe llojin e efekteve të decentralizimit mbi ingjercën konkrete të komunës, si dhe mënyrave dhe kapaciteteve të komunës për implementimin e tyre. Vlerat e indekseve (IPD dhe IDF) janë në interval prej 1 deri në 5, ku vlerat më të larta të indekseve flasin për nivel më të lartë të implementimit të decentralizimit në ingjercën konkrete dhe efekte të larta të implementimit të ingjercës, kurse vlerat e ulëta të indekseve tregojnë që në komunë ka nivel të ulët të implementimit të ingjercës.

Pikënisja për llogaritjen e vlerës së indekseve është përcaktimi i vlerës së treguesve dhe vlerësimi adekuat i secilit tregues që është shfrytëzuar. Këto nota jepen në bazë të ndryshoreve të analizuara (të dhënave) dhe/ose vlerave të fituara nga analizat, ku janë shfrytëzuar ndryshoret e fituara nga hulumtimet primare (pyetësorë dhe intervista). Në bazë të ndryshoreve dhe/ose vlerave të fituara për çdo tregues, si dhe në bazë të kriterëve të definuara paraprakisht për vlerësimin e treguesve, secili prej tyre merr notë prej 1 deri në 5. Kriteret për vlerësimin e treguesve në çdo fushë prezantohen në vijim.

Me qëllim të sigurimit të vlerësimit më relevant dhe më real të indekseve (IPD dhe IDF), notat e treguesve dhe nën-indekseve vlerësohen sipas peshës, gjegjësisht çdo tregues dhe nën-indeks ka vlerë të peshës dhe sipas kësaj merr pjesë në llogaritjen dhe fitimin e indeksit final. Vlerat e peshës për çdo tregues dhe nën-indeks janë fituar si masë mesatare e vlerësimeve të intervistave të nëpunësve shtetërorë dhe kryetarëve të komunave në çdo partner-komunë – në bazë të vështrimit të tyre për rëndësinë (peshën) e çdo treguesi dhe nën-indeksi.

Do të thotë, notat e fituara për çdo tregues, ponderohen me vlerat e peshës së treguesve dhe fitohen vlerat e peshës së notave të treguesve, që pastaj mbledhen dhe kështu jepen nën-indeksit gjegjëse. Çdo nën-indeks ponderohet tutje me faktorin gjegjës të peshës dhe vlerat e shumave të mbledhura të nën-indekseve e japin indeksin përfundimtar (IDF ose IPD).

Do të thotë, së pari llogaritet vlera e çdo nën-indeksi sipas formulës:

$$P_x = \sum_{k=1}^n t(k) * O(k)$$

ku:

P_x është vlera e nën-indeksit x (x=1, 2, 3, 4);

n është numri i treguesve që e formojnë nën-indeksin;

t është faktori i peshës për çdo tregues k dhe

O është nota për çdo tregues.

Pas llogaritjes së vlerës së çdo nën-indeksi, vlera e indeksit për performanset e decentralizimit (IPD) në fushën e caktuar llogaritet sipas formulës:

$IPD = T1*PI1 + T2*PI2 + T3*PI3 + T4*PI4$, ku:

T1 deri T4 janë faktorë të peshave të nën-indekseve, kurse

PI1 deri PI4 janë vlera të nën-indekseve.

Me fjalë tjera, kjo mënyrë e llogaritjes së nën-indekseve dhe indekseve mundëson që gjatë llogaritjes së IPD-së, të gjithë treguesit dhe nën-indeksit të mos kenë ndikim të njëjtë. Çdo tregues dhe nën-indeksi merr pjesë me peshën (rëndësinë) e vendosur nga nëpunësit përgjegjës shtetërorë në fushat e tyre, si dhe kryetarët e komunave-partnere.

Për llogaritjen e vlerës së treguesve, si bazë për përcaktimin e vlerës së nën-indekseve dhe indekseve janë shfrytëzuar të dhënat (variablet) cilësore dhe sasiore, të fituara përmes hulumtimeve primare të realizuara në të gjitha administratat komunale të komunave-partnere. Hulumtimi themelor i ka përfshirë intervistat me nëpunësit shtetërorë në terren, si dhe plotësimin e pyetësorëve të përgatitur paraprakisht. Pyetësorët e plotësuar jepen në Aneksin e këtij raporti. Me qëllim të sigurimit të të dhënave sa më relevante, si plotësim janë shfrytëzuar edhe burime sekondare të të dhënave, si për shembull informatat zyrtare të gazetave zyrtare të komunave, llogarive përfundimtare të buxheteve të partner-komunave për vitin 2008 dhe 2009, që janë siguruar nga komunat. Hulumtimi në terren është realizuar në periudhën shtator-tetor të vitit 2010.

Treguesit për matjen e indeksit të performansave të komunës (IPD) në fushën e **Arsimit, urbanizimit dhe planifikimit** hapësinor dhe indeksi i decentralizimit fiskal (IDF), përfshirë edhe treguesit për matjen e transparencës dhe llogaridhënies, prezantohen më poshtë, së bashku me vlerat e peshave për çdo tregues dhe nën-indeksi, ndaras për çdo fushë.

2.3 Definimi i treguesve dhe kriteret për vlerësim

2.3.1 IDF – Indeksi i decentralizimit fiskal

Në tabelën në vijim jepet lista e treguesve, grupimi i tyre në nën-indekse, si dhe variablet cilësore dhe sasiore që janë shfrytëzuar për llogaritjen e vlerës së çdo treguesi. Prezantohen edhe vlerat e peshës së çdo treguesi dhe nën-indeksi, gjegjësisht rëndësia dhe pjesëmarrja e tyre në formimin e Indeksit të decentralizimit fiskal (IDF):

Tabela 1: Treguesit dhe variablet në IDF

NËN-INDEKSET		TREGUESIT		
Faktori i peshës	Definicioni	Faktori i peshës	Definicioni	Variablet cilësore dhe sasore
28%	1. Nën-indeksi i implementimit të politikave për decentralizimin fiskal	11%	1.1. Pjesëmarrja e të dalave komunale në totalin e shpenzimit publik në RM për kokë banori	1. Gjithsej të dalat e komunës/banor 2. Gjithsej shpenzimi publik në RM/banor
		25%	1.2. Pjesëmarrja e të hyrave në buxhetin themelor, krahasuar me total të hyrat	1. Të hyrat e buxhetit themelor të komunës 2. Gjithsej të hyrat e komunës
		19%	1.3. Niveli i autorizimeve për vendim-marrje vetanake	1. Shuma e të hyrave për të cilat komuna vetë i cakton tarifrat 2. Gjithsej të hyrat e komunës (komplet buxheti)
		12%	1.4. Kontrolli lokal mbi transferet e pushtetit lokal	1. Transferet e buxhetit themelor 2. Gjithsej transfere
		23%	1.5. Pjesëmarrja e të dalave kapitale në totalin e të dalave	1. Gjithsej të dala kapitale 2. Gjithsejtë të dala
		10%	1.6. Pjesëmarrja e mjeteve vetanake në financimin e programeve/fushave (rugët, arsimi, mbrojtja sociale, mbrojtja kundër zjarrit, komunalet, kultura dhe sporti)	1. Gjithsej të dala sipas fushave/programeve 2. Gjithsej transfere nga pushteti qendror sipas fushave/programeve
		37%	2. Nën-indeksi i gjendjes financiare të NJVL-së	12%
14%	2.2. Të dalat kapitale të komunës për kokë banori (dhe krahasimi me RM)			1. Gjithsej të dala kapitale 2. Numri i banorëve në komunë
25%	2.3. Të dalat lokale sipas artikujve ekonomikë			1. Artikujt e të dalave zhvillimore (46+47+48) 2. Artikujt operativë-administrativë (40+41+42)
17%	2.4. Disponueshmëria e të dalave operative			1. Të hyrat vjetore operative (71+72) 2. Gjithsej të hyrat e komunës
22%	2.5. Struktura e të hyrave			1. Gjithsej të hyrat 2. Të hyrat e transfereve dhe donacioneve
10%	2.6. Të hyrat për banor (krahasimi me RM)			1. Gjithsej të hyrat 2. Numri i banorëve në komunë

21%	3. Nën-indeksi i gjendjes së përgjithshme ekonomike të komunës	31%	3.1. Niveli i papunësisë	1. Numri i personave të papunësuar 2. Numri i popullatës aktive ekonomike
		32%	3.2. Niveli i varfërisë	1. Popullata e varfër (sipas EShS) 2. Gjithsej popullata
		37%	3.3. Të hyrat për amvisëri	1. Numri i amvisërive 2. Gjithsej të hyrat mesatare për amvisëri
14%	4. Nën-indeksi i transparencës dhe llogaridhënies	39%	4.1. Qasja ndaj informatave për buxhetin dhe llogarinë finale të komunës	1. Informatat për buxhetin dhe llogarinë vjetore janë me qasje publike
				2. Ekzistojnë procedura zyrtare për mënyrën në të cilën qytetarët njihen me planifikimin dhe realizimin e buxhetit komunal
				3. Format e pjesëmarrjes së qytetarëve në krijimin e buxhetit komunal
32%	4.2. Llogaridhënia e punës	1. Auditori intern		
		2. Raportet e auditimit të Entit Shtetëror për Auditim publikohen, në nivel lokal në komunë		
29%	4.3. Qasja ndaj informatave të karakterit publik	1. Numri i kërkesave të përgjegjura për qasje ndaj informatave me karakter publik		
		2. Komuna i është nënshtruar EShA 2008/09		
		3. Qasja ndaj dokumenteve të auditimit të kryer nga Entit Shtetëror për Auditim (EshA)		

Kriteret për përcaktimin e vlerës dhe notës adekuate për çdo tregues jepen në tabelën në vijim. Vlera e të gjithë treguesve prej 1.1 deri në 3.3 fitohet si raport mes dy variableve të i

treguesit gjegjësisht dhe varësisht nga vlera e fituar, këtij raporti i jepet nota e treguesit. Për vlerësimin e treguesve 4.1-4.3 janë aplikuar kriteret tjera, që jepen në vijim në Tabelën 2:

Tabela 2: Kriteret për vlerësimin e treguesve fiskalë

Definimi i treguesit	Ndryshoret cilësore dhe sasiore	KRITERI dhe NOTA				
		1	2	3	4	5
1.1. Pjesëmarrja e të dalave komunale në totalin e shpenzimit publik në RM për kokë banori	1. Gjithsej të dalat e komunës/banor	< 0,08	0,09	0,12 –	0,15 –	> 0,18
	2. Gjithsej shpenzimi publik në RM/banor		-0,11	0,14	0,17	
1.2. Pjesëmarrja e të hyrave në buxhetin themelor, krahasuar me total të hyrat	1. Të hyrat e buxhetit themelor të komunës	< 0,30	0,31	0,36 –	0,41 –	> 0,46
	2. Gjithsej të hyrat e komunës		-0,35	0,40	0,45	

1.3. Niveli i autorizimeve për vendim-marrje vetanake	1. Shuma e të hyrave për të cilat komuna vetë i cakton tarifat	< 0,10	0,11 – 0,15	0,16 – 0,20	0,21 – 0,30	> 0,31
	2. Gjithsej të hyrat e komunës (komplet buxheti)					
1.4. Kontrolli lokal mbi transferet e pushtetit lokal	1. Transferet e buxhetit themelor	< 0,10	0,11 – 0,15	0,16 – 0,20	0,21 – 0,30	> 0,31
	2. Gjithsej transfere					
1.5. Pjesëmarrja e të dalave kapitale në totalin e të dalave	1. Gjithsejtë dala kapitale	< 0,10	0,11 – 0,15	0,16 – 0,20	0,21 – 0,30	> 0,31
	2. Gjithsej të dala					
1.6. Pjesëmarrja e mjeteve vetanake në financimin e programeve/fushave (rrugët, arsimi, mbrojtja sociale, mbrojtja kundër zjarrit, komunalet, kultura dhe sporti)	1. Gjithsej të dala sipas fushave/ programeve	< 1,00	1, 01 – 1, 30	1,31 – 1,50	1,51 – 1,90	> 1,91
	2. Gjithsej transfere nga pushteti qendror sipas fushave/ programeve					
2.1. Balansi vjetor financiar (rezerva)	1. Gjithsej të hyra vjetore	< 0,05	0,06 – 0,09	0,10 – 0,12	0,13 – 0,15	> 0,15
	2. Gjithsej të dala vjetore					
2.2. Të dalat kapitale të komunës për kokë banori (dhe krahasimi me RM)	1. Gjithsej të dala kapitale	< 500	500 – 1.000	1.000 – 1.500	1.500 – 2.000	> 2.000
	2. Numri i banorëve në komunë					
2.3. Të dalat lokale sipas artikujve ekonomikë	1. Artikujt e të dalave zhvillimore (46+47+48)	< 0,15	0,16 – 0,25	0,26 – 0,35	0,35 – 0,40	> 0,41
	2. Artikujt operativë-administrativë (40+41+42)					
2.4. Disponueshmëria e të dalave operative	1. Të hyrat vjetore operative (71+72)	< 0,15	0,16 – 0,25	0,26 – 0,35	0,35 – 0,40	> 0,41
	2. Gjithsej të hyrat e komunës					
2.5. Struktura e të hyrave	1. Gjithsej të hyrat	< 1,00	1,01 – 1,25	1,26 – 1,50	1,51 – 1,80	> 1,81
	2. Të hyrat e transfereve dhe donacioneve					
2.6. Të hyrat për banor (krahasimi me RM)	1. Gjithsej të hyrat	<5.000	5.001 – 7.000	7.001– 9.000	9.001 – 11.000	> 11.001
	2. Numri i banorëve në komunë					
3.1. Niveli i papunësisë	1. Numri i personave të papunësuar	> 0,61	0,60 – 0,46	0,45 – 0,31	0,30 – 0,16	< 0,15
	2. Numri i popullatës aktive ekonomike					
3.2. Niveli i varfërisë	1. Popullata e varfër (sipas EShS)	0,48		0,392		0,128
	2. Gjithsej popullata					
3.3. Të hyrat për amvisëri	1. Numri i amvisërive	< 5.000	5.000 – 10.000	10.001 – 15.000	15.001– 20.000	> 20.000
	2. Gjithsej të hyrat mesatare për amvisëri					

4.1. Qasja ndaj informatave për buxhetin dhe llogarinë finale të komunës	1. Informatat për buxhetin dhe llogarinë vjetore janë me qasje publike	Nuk janë të kapshme – 0, deri në 2 mënyra të informimit – 1 pikë, më shumë se 2 mënyra - 2 pika
	2. Ekzistojnë procedura zyrtare për mënyrën në të cilën qytetarët njihen me planifikimin dhe realizimin e buxhetit komunal	Nuk ka procedura zyrtare – 0, ka –1 pikë
	3. Format e pjesëmarrjes së qytetarëve në krijimin e buxhetit komunal	Nuk ka pjesëmarrje – 0, deri në 2 mënyra – 1 pikë, më shumë se 2 mënyra – 2 pikë
4.2. Llogaridhënia e punës	1. Auditori intern	Nuk janë emëruar auditorë – 0 pikë, janë emëruar – 1, ka auditor dhe procedura – 3 pikë
	2. Raportet e auditimit të Entit Shtetëror për Auditim publikohen, në nivel lokal në komunë	Jo – 0, Nuk ka pasur auditim –1, Po – 2
4.3. Qasja ndaj informatave të karakterit publik	1. Numri i kërkesave të përgjegjura për qasje ndaj informatave me karakter publik	Të gjitha janë përgjigjur – 2, nuk ka kërkesa ose përgjigje të pjesërishme – 1, asnjëra – 0
	2. Komuna i është nënshtruar ESHA 2008/09	Jo – 0, Po – 1
	3. Qasja ndaj dokumenteve të auditimit të kryer nga Entit Shtetëror për Auditim (EshA)	Ka qasje publike në komunë – 2, nuk ka qasje – 0

2.3.2 IPD - Arsimi

Zgjedhja e treguesve në fushën e arsimit është dizajnuar për përfshirjen e tre ingjerencave kyçe të komunës në fushën e arsimit: themelimi, financimi dhe administrimi i shkollave fillore dhe të mesme. Përveç kësaj, janë marrë parasysh edhe konstatimet e "Mbikëqyrjes së realizimit të decentralizimit – analiza krahasuese e punës së komunave për vitin 2004-2008"⁸, ku njëherazi është kryer edhe kontrolli dhe rigrupimi i tyre, në pajtim me qasjen e përcaktuar metodologjike dhe kornizën analitike.

8. Vëzhgimi i realizimit të decentralizimit – analiza krahasuese e punës së komunave në periudhën 2004-2006. Qershor 2009, FIShHM, Shkup

Në Tabelën 3 jepet lista e treguesve, grupimi i tyre në nën-indekse, si dhe variablet cilësore dhe sasiore që janë shfrytëzuar për llogaritjen e vlerës së çdo indikatorit. Gjithashtu, janë prezantuar edhe vlerat e

rëndësisë së çdo indikatorit dhe nën-indeksi, gjegjësisht rëndësia dhe pjesëmarrja e tyre në formimin e indeksit të performansave të decentralizimit në fushën e arsimit (IPDA).

Nën-indeks		Treguesit		Variablet sasiore dhe cilësore
Faktori i rëndësisë	Përkufizimi	Faktori i rëndësisë	Përkufizimi	
27%	1. Nën-indeksi i implementimit të politikave të decentralizimit në pjesën e arsimit	22%	1.1. Komuna merr pjesë aktive në punën e këshillave shkollorë	Gjithsej numri i shkollave fillore; numri i shkollave fillore ku komuna ka emëruar përfaqësues në këshillat shkollorë; dinamika e raportimit të Kryetarit të komunës për punën e këshillave shkollorë.
		14%	1.2. Komuna ndërmerri dhe realizon nisma për hapjen e shkollave të reja dhe mbylljen e shkollave ekzistuese	Numri i elaborateve për hartuara për krijimin e shkollave të reja ose mbylljen e shkollave ekzistuese; numri i propozimeve të parashtruara në MASH për themelimin ose mbylljen e shkollave fillore; numri i propozimeve të pranuar nga MASH; numri i propozimeve të parashtruara në Këshillin komunal për themelimin e shkollave fillore; numri i propozimeve të realizuara.
		26%	1.3. Komuna i respekton ligjet dhe politikat e arsimit themelor	Numri i mbikëqyrjeve të realizuara nga MASH; numri dhe lloji i masave të shqiptuara si rezultat i mbikëqyrjeve; numri i raporteve të dorëzuara për konstatimet e Inspektoratit shtetëror të arsimit, që lidhen me punën e komunave.
		20%	1.4. Komuna mban dokumentacion të rregullt për shkollat e saj, sipas rregullativës ligjore	Mbajtja e rregullt e regjistrave për shkollat në territorin e komunës, që parashihet me Ligjin për arsim fillor; mbajtja e regjistrave tjerë dhe llojet e tyre.
		18%	1.5. Komuna e ka ndërmarrë pronësinë mbi objektet shkollore	Numri i objekteve shkollore për arsim fillor; numri i objekteve shkollore për të cilat komuna posedon fletë të pronësisë në emër të saj.
32%	2. Nën-indeksi i gjendjes financiare të komunës në pjesën e arsimit	5%	2.1. Raporti mes totalit të mjeteve të shpenzuara për arsim dhe mjeteve të fituara me dotacionet e pushtetit qendror	Blok-dotacionet për arsimin fillor dhe të mesëm, mjetet e realizuara për arsimin fillor dhe të mesëm.
		25%	2.2. Pjesëmarrja e mjeteve komunale në totalin e shpenzimeve për arsim	Mjetet vetanake të investuara për mirëmbajtje vijuese, investimet kapitale dhe mjetet ndihmëse mësimore për arsimin fillor dhe të mesëm, gjithsej të dalat për arsim, numri i nxënësve.
		15%	2.3. Të dalat kapitale të dedikuara për arsim	Kapitalite rashodi za osnovno i sredno, od centralno i lokalno nivo, vo odnos na vkupnite kapitali rashodi na opština.
		10%	2.4. Shuma e dotacioneve kapitale për arsim, të fituara në nivel qendror, në emër dhe dispozicion të shkollës	Shuma e mjeteve për investime kapitale, të fituara nga niveli qendror dhe që janë në dispozicion dhe emër të komunës.

Faktori i rëndësishë	Nën-indeksset		Treguesit		Variablet sasiore dhe cilësore
	Përkufizimi		Faktori i rëndësishë	Përkufizimi	
32%	2. Nën-indeksi i gjendjes financiare të komunës në pjesën e arsimit		20%	2.5. Kuadri plotësues mësimdhënës që financohet nga komuna	Numri i mësimdhënësve të angazhuar në mënyrë plotësuese, të pagur nga komuna/numri i nxënësve.
			30%	2.6. Menaxhmenti efektiv financiar i sistemit arsimor lokal	1. Vendimi i Këshillit komunal për matjen dhe kriteret e shpërndarjes së mjeteve mes shkollave të komunës; 2. Procedurat e krijuara lokale për rregullimin e punës buxhetore dhe planifikimit të shkollave; 3. Komuna harton analiza të gjendjes financiare dhe nevojave të komunave në bazë të treguesve organizativë, financiarë dhe tjerë; 4. Komuna harton elaborate për racionalizimin e shpenzimeve të shkollave; 5. Transferi i mjeteve financiare në shkolla në kohën e duhur.
25%	3. Nën-indeksi i performanseve të shërbimeve komunale në pjesën e arsimit		35%	3.1. Shkollat pajisen drejt harmonizimit me Normativat dhe standardet e hapësirës dhe pajisjes	Njohja me Normativat dhe standardet për hapësirën dhe pajisjes së shkollave; incizimi dhe analiza e realizuar për pajisjen me mjete ndihmëse; furnizimi me mjete mësimdhënëse në shkollat e komunës.
			23%	3.2. Efektiviteti në sigurimin e transportit dhe ngrohjes falas për nxënësit	Mënyra e realizimit të furnizimeve publike; Rregullshmëria e sigurimit të ngrohjes dhe transportit të nxënësve.
			21%	3.3. Kapaciteti organizativ për menaxhim me sistemin arsimor	Organizimi i arsimit në kuadër të administratës komunale; mënyra e komunikimit të administratës me shkollat.
			21%	3.4. Qasja strategjike në menaxhimin me sistemin dhe shërbimet lokale arsimore	Ekzistimi i Strategjisë për zhvillimin e arsimit; numri i projekteve të Strategjisë që parashihen në buxhet dhe që janë zbatuar; gjatë vendim-marrjes strategjike është marrë parasysh vetë-vlerësimi i shkollave.
16%	4. Nën-indeksi i transparencës dhe llogaridhënies në pjesën e arsimit		45%	4.1. Transparenca dhe llogaridhënia e punës së komunës në fushën e arsimit	Mënyra e informimit të qytetarëve për çështjet e lidhura me arsimin; takimet mes përfaqësuesve të këshillave shkollorë dhe administratës komunale; takimet me asociacioneve rinore dhe kryesisë komunale mbi temat arsimore.
			55%	4.2. Llogaridhënia e punës dhe qasja ndaj informatave me karakter publik	Publikimi i temave të arsimit në raportet ose materialet informative për qytetarët; publikimi i planeve financiare dhe llogarive përfundimtare të shkollave të komunës në gazetën zyrtare; informatat publike të lidhura me arsimin janë publikuar në internet-faqen e komunës; raportet e vetë-vlerësimit të shkollave publikohen në ueb-faqen e komunës.

Kriteret për caktimin e vlerës dhe notës adekuate për secilin tregues të prezantuar në Tabelën 4:

Tabela 4: Kriteret për vlerësimin e treguesve të arsimit

TREGUESI	Niveli/nota 5	Niveli/nota 4	Niveli/nota 3	Niveli/nota 2	Niveli/nota 1
1.1. Komuna merr pjesë aktive në punën e këshillave shkollorë	Janë emëruar përfaqësues në të gjitha këshillat shkollorë; raportohet për çdo mbledhje ose kohë pas kohe	Janë emëruar përfaqësues në 41-80% të këshillave shkollorë; raportohet për çdo mbledhje ose kohë pas kohe	Janë emëruar përfaqësues në 41-60% të këshillave shkollorë; raportohet për çdo mbledhje ose kohë pas kohe	Janë emëruar përfaqësues në 21-41% të këshillave shkollorë; raportohet për çdo mbledhje ose kohë pas kohe	Janë emëruar përfaqësues në më pak se 20 % të këshillave shkollorë; nuk raportohet për çdo mbledhje ose kohë pas kohe
1.2. Komuna ndërmerr dhe realizon nisma për hapjen e shkollave të reja dhe mbylljen e shkollave ekzistuese	Është hartuar një ose më tepër elaborete dhe është realizuar të paktën një nismë	Është hartuar një ose më tepër elaborete, është pranuar nga MASH dhe nisma është dhanë për vendim-marrje në Këshillin komunal	Është bërë të paktën një elaboret dhe nisma është dërguar në MASH, ku pritet vendim-marrja	Nisma për ndryshimin e rrjetit është në fazë të përpunimit, por nuk është dërguar në MASH	Nuk janë bërë elaboretet, as nismat për ndryshime në rrjet
1.3. Komuna i respekton ligjet dhe politikat e arsimit themelor	Mos-ekzistimi i masave të shqiptuara gjatë mbikëqyrjes së MASH-it; komunikimi me Inspektoratin e arsimit (ISHA) është i rregullt	Janë shqiptuar masa dhe nisma për ushtrimin e përgjithshëm të ingerencave, komunikimi me ISHA është i rregullt	Janë shqiptuar urdhra për mangësitë materiale dhe procedurale, komunikimi me ISHA është i rregullt	Janë shqiptuar urdhra për ligjshmërinë e vendimeve, kurse komunikimi me ISHA nuk është i rregullt	Është shqiptuar masa për marrjen e ingerencës nga MASH; nuk ekziston komunikim me ISHA
1.4. Komuna mban dokumentacion të rregullt për shkollat e saj, sipas rregullatës ligjore	Përveç regjistrave të obligueshme, mbahen edhe data-baza dhe regjistra plotësuese	Mbahen regjistrat e obligueshme ligjore, mblidhen edhe të dhëna tjera që nuk janë sistemuar	Mbahen regjistrat e obligueshme me ligj dhe në formë të sistemuar	Mbahen regjistrat e obligueshme me ligj, por jo në formë të sistemuar	Komuna nuk i mban regjistrat e shkollave që parashihen me ligj
1.5. Komuna e ka ndërmarrë pronësinë mbi objektet shkollorë	Mbi 81%	61 – 80%	41 – 60%	21 – 40%	Më pak se 20 %
2.1. Raporti mes totalit të mjeteve të shpenzuara për arsim dhe mjeteve të fituara me dotacionet e pushtetit qendror	>111%	101 – 110%	90,1 – 100%	81 – 90%	<80%
2.2 Pjesëmarrja e mjeteve komunale në totalin e shpenzimeve për arsim	>30,1%	10,1 – 30,0 %	3,1 – 10%	0,1 – 3%	0%

2.3. Të dalat kapitale të dedikuara për arsim	>10,1%	7,01 – 10%	3,01 – 7%	0,1 – 3%	0%
2.4. Shuma e dotacioneve kapitale për arsim, të fituara në nivel qendror, në emër dhe dispozicion të shkollës	>1.000	600 – 999	300 – 599	1 – 299	0
2.5. Kuadri plotësues mësimdhënës që financohet nga komuna	>20	10 – 19	2 – 9	1	0
2.6. Menaxhmenti efektiv financiar i sistemit arsimor lokal	<p>Për çdo kriter të cekur, fitohet një pikë nëse është përmbushur kriteri:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vendimi i Këshillit komunal për masat dhe kriteret e ndarjes së mjeteve mes shkollave në komunë; 2. Janë krijuar procedura lokale për rregullimin e punës buxhetore dhe planifikimit të shkollave; 3. Komuna e harton analizën e gjendjes financiare dhe nevojat e shkollave, të hartuar në bazë të treguesve organizativë, financiarë dhe tjerë; 4. Komuna harton elaborate për racionalizimin e shpenzimeve në shkolla dhe 4. Transferet në kohën e paraparë për transferimin e mjeteve financiare tek shkollat. 				

3.1. Shkollat pajisen drejt harmonizimit me Normativat dhe standardet e hapësirës dhe pajisjes	Njohja me normat, analizat e realizuara dhe mjetet plotësuese që janë investuar	Njohja me normat, analizat e realizuara ose mjetet plotësuese që janë investuar për mjetet ndihmëse mësimore	Nuk ekziston njohja me normat, nuk janë kryer incizime dhe analiza, por janë investuar mjete për mjetet ndihmëse mësimore	Nuk ekziston njohja me normat, por janë kryer incizime dhe analiza. Nuk janë investuar mjete për mjetet ndihmëse mësimore	Nuk ekziston njohja me normat, nuk janë kryer incizime dhe analiza. Nuk janë investuar mjete për mjetet ndihmëse mësimore
3.2. Efektiviteti në sigurimin e transportit dhe ngrohjes falas për nxënësit	Furnizimet publike kryhen në nivel lokal dhe nuk ka pasur asnjë vonesë në sigurimin e shërbimit, as ndërprerje të mësimdhënies	Furnizimet publike kryhen në nivel lokal dhe ka pasur vonesa në sigurimin e shërbimit për shkak të vonesës së realizuesit ose për shkak të pengesave procedurale – pa ndërprerje të mësimdhënies	Furnizimet publike kryhen në nivel lokal dhe ka pasur vonesa në sigurimin e shërbimit për shkak të vonesës së shpalljes së procedurës tenderuese – pa ndërprerje të mësimdhënies	Furnizimet publike kryhen në nivel lokal, me vonesa të shërbimeve për arsye të ndryshme – pa ndërprerje të mësimdhënies	Furnizimet publike nuk kryhen në nivel lokal, me vonesa të shërbimeve për arsye të ndryshme – me ndërprerje të mësimdhënies
3.3. Kapaciteti organizativ për menaxhim me sistemin arsimor	Të paktën një person punon ekskluzivisht në fushën e arsimit; ekziston inspektori lokal për arsim; aplikohen më shumë se tre mënyra të komunikimit me shkollat, përfshirë edhe vizitat personale	Është punësuar personi që pjesërisht punon në fushën e arsimit; ekziston inspektori lokal për arsim; aplikohen dy mënyra të komunikimit me shkollat	Është punësuar personi që pjesërisht punon në fushën e arsimit; nuk ka inspektor lokal për arsim; aplikohen deri në dy mënyra të komunikimit me shkollat	Nuk ka person me obligime të punës në arsim; nuk ka inspektor lokal për arsim, por ka komunikim direkt me shkollat për planet financiare	Nuk ka person me obligime të punës në arsim; nuk ka inspektor lokal për arsim, shkollat nuk vizitohen personalisht
3.4. Qasja strategjike në menaxhimin me sistemin dhe shërbimet lokale arsimore	Ka strategji për arsim, projekte të buxhetuara; vetë-vlerësimi i shkollave përfshihet në planifikimin strategjik	Ka strategji, por nuk ka projekte të buxhetuara; vetë-vlerësimi nuk merret parasysh	Ka strategji, por si pjesë e strategjisë për Zhvillimit ekonomik lokal (ZHEL). Ka projekte të buxhetuara, por rezultatet e vetë-vlerësimit nuk merren parasysh	Strategjia për arsim është në fazë përgatitore. Rezultatet e vetë-vlerësimit nuk merret parasysh	Nuk ka strategji, vetë-vlerësimi nuk merret parasysh gjatë planifikimit strategjik

<p>4.1. Transparenca dhe llogaridhënia e punës së komunës në fushën e arsimit</p>	<p>> 4 mënyra për informimin e qytetarëve; organizohen takime me Këshillin shkollor; organizohen takime me shoqatat e qytetarëve</p>	<p>> 4 mënyra për informimin e qytetarëve; organizohen takime me Këshillin shkollor; nuk organizohen takime me shoqatat e qytetarëve</p>	<p>< 3 mënyra për informimin e qytetarëve; nuk organizohen takime me Këshillin shkollor; organizohen takime me shoqatat e qytetarëve</p>	<p>Qytetarët informohen në masë të kufizuar për çështjet e arsimit; nuk organizohen takime me Këshillin shkollor; nuk organizohen takime me shoqatat e qytetarëve</p>	<p>Qytetarët nuk informohen për çështjet e arsimit; nuk organizohen takime me Këshillin shkollor; nuk organizohen takime me shoqatat e qytetarëve</p>
<p>4.2. Llogaridhënia e punës dhe qasja ndaj informatave me karakter publik</p>	<p>Arsimi përfaqësohet në raportet dhe materialet informative; raportet financiare të shkollave publikohen në gazetën zyrtare; informatat publike mbi arsimin publikohen në ueb-faqen e komunës; raportet e vetë-vlerësimit publikohen në ueb-faqen e komunës</p>	<p>Arsimi përfaqësohet në raportet dhe materialet informative; raportet financiare të shkollave publikohen në gazetën zyrtare; informatat publike mbi arsimin publikohen në ueb-faqen e komunës; raportet e vetë-vlerësimit nuk publikohen në ueb-faqen e komunës</p>	<p>Arsimi përfaqësohet pjesërisht në raportet dhe materialet informative; raportet financiare të shkollave publikohen në gazetën zyrtare; informatat publike mbi arsimin nuk publikohen në ueb-faqen e komunës; raportet e vetë-vlerësimit nuk publikohen në ueb-faqen e komunës</p>	<p>Arsimi nuk përfaqësohet në raportet dhe materialet informative; raportet financiare të shkollave publikohen në gazetën zyrtare; informatat publike mbi arsimin nuk publikohen në ueb-faqen e komunës; raportet e vetë-vlerësimit nuk publikohen në ueb-faqen e komunës</p>	<p>Arsimi nuk përfaqësohet në raportet dhe materialet informative; raportet financiare të shkollave nuk publikohen në gazetën zyrtare; informatat publike mbi arsimin nuk publikohen në ueb-faqen e komunës; raportet e vetë-vlerësimit nuk publikohen në ueb-faqen e komunës</p>

2.3.3 IPD – Urbanizmi dhe planifikimi hapësinor

Vëzhgimi i fushës së urbanizmit dhe planifikimit hapësinor do ta mundësojë mbledhjen e informatave dhe të dhënave, të nevojshme për kryerjen e analizës, me fokus të veçantë në:

1. Lëshimin e lejeve ndërtimore (ingjercë e re e decentralizuar) dhe
2. Planifikimin e hapësirës në pjesën e planeve gjenerale urbanistike (PGJU), planeve të detajuara urbanistike (PDU), PU për fshatrat dhe PU për vendet jashtë lagjeve të banuara (ingjercë e vjetër-ekzistuese).

Në tabelën 5 jepet lista e treguesve, grupimi i tyre në nën-indekse, si dhe variabëlët cilësore dhe sasore të aplikuar gjatë llogaritjes së vlerës së treguesve. Prezantohen edhe vlerat e rëndësisë së treguesve dhe nën-indekseve, gjegjësisht rëndësia dhe pjesëmarrja e tyre në formimin e indeksit të performansave të decentralizimit, në fushën e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor (IPDU). Si edhe në pjesën e arsimit, disa prej këtyre treguesve janë aplikuar edhe herën e kaluar kur është vëzhguar realizimi i decentralizimit.

Tabela 5: Treguesit dhe variablet në IPD-urbanizëm

Faktori i rëndësishë	Nën-indeksset	Faktori i rëndësishë	Treguesit	Të dhënat sasiore dhe cilësore
	Përkufizimi		Përkufizimi	
28%	1. Nën-indeksi i implementimit të politikave në urbanizëm	32%	1.1 Bashkëpunimi mes komunës dhe pushtetit qendror	1. Numri i pëlqimeve të pranuar nga ministrinë 2. Numri i pëlqimeve të kërkuara nga ministrinë
		68%	1.2 Liria e realizimit të injerencave	1. Notat e udhëheqësve të sektorëve/seksioneve të urbanizmit dhe kryetarëve të komunave
31%	2. Nën-indeksi i gjendjes financiare të komunës në fushën e urbanizmit	21%	2.1 Aftësia financiare e komunës për implementimin e planeve urbane	1. Gjithsej të dala kapitale 2. Gjithsej të dala
		21%	2.2 Shpenzimet kapitale të komunës për kokë banori	1. Gjithsej të dala kapitale 2. Numri i banorëve në komunë
		35%	2.3 Aftësia financiare e komunës për hartimin e planeve urbane	1. Shuma e mjeteve vetanake që komuna i ka shpenzuar për financimin e hartimit të planeve urbane 2. gjithsej mjete të shpenzuara për financimin e hartimit të planeve urbane
		23%	2.4 Kapaciteti i komunës për shembjen e objekteve të ndërtuara pa leje	1. Shuma e mjeteve të realizuara për shembjen e objekteve të ndërtuara pa leje 2. Shuma e mjeteve të parapara për shembjen e objekteve të ndërtuara pa leje
24%	3. Nën-indeksi i performanseve të shërbimeve komunale në pjesën e urbanizmit	28%	3.1 Mbulimi i komunës me PGJU, PDU, plan urban për fshatra dhe planet për vendet jashtë lagjeve të banuara	1. Sipërfaqja e komunës që mbulohet me plan urban (ha) 2. Gjithsej sipërfaqja e komunës (ha)
		9%	3.2 Efikasiteti i lëshimit të ekstrakteve të planeve urbane	1. Numri i ekstrakteve të lëshuara të planit urban (PU) 2. Numri i kërkesave të parashtruara për ekstrakt të PU
		12%	3.3 Efikasiteti i lëshimit të vendimit për kushtet e lokacionit	1. Numri i vendimeve të lëshuara për kushtet e lokacionit 2. Numri i kërkesave të parashtruara për kushtet e lokacionit
		12%	3.4 Efikasiteti i lëshimit të lejes për ndërtim	1. Numri i lejeve të lëshuara për ndërtim 2. Numri i kërkesave të parashtruara për leje ndërtimi
		12%	3.5 Efikasiteti i lëshimit të lejes për shfrytëzim	1. Numri i lejeve të lëshuara për shfrytëzim 2. Numri i kërkesave të parashtruara për leje për shfrytëzim
		15%	3.6 Performanset e inspeksionit urbanistik dhe ndërtimor	1. Numri i vendimeve të realizuara për shembjen e objekteve të ndërtuara pa leje 2. Numri i vendimeve të miratuara për shembjen e objekteve të ndërtuara pa leje
		12%	3.7 Inovacioni gjatë zbatimit të injerencave	1. Formularët e fushës së urbanizmit jepen në internet 2. Komuna posedon kompjuterët me softuer të licencuar dhe instaluar për GIS 3. Komuna ka të punësuar që kanë njohuri për krijimin e bazave të të dhënave dhe prezantimit grafik me GIS softuer

Faktori i rëndësishë	Nën-indeks	Faktori i rëndësishë	Treguesit	Të dhënat sasiore dhe cilësore
	Përkufizimi		Përkufizimi	
17%	4. Nën-indeksi i transparencës dhe llogaridhënies në fushën e urbanizmit	39%	4.1 Niveli i përfshirjes së qytetarëve në çështjet e planifikimit hapësinor dhe planifikimit urban me karakter lokal	1. Numri i mënyrave për mbledhjen e informatave kthyesë nga qytetarët 2. Numri i formave të organizuara të pjesëmarrjes së qytetarëve në procedurat e miratimit të PU
		30%	4.2 Llogaridhënia për punën	1. Numri i mënyrave për informimin e qytetarëve për çështjet e fushës së urbanizmit
		31%	4.3 Qasja ndaj informatave të karakterit publik	1. Numri i kërkesave të përgjigjura për qasje ndaj informatave me karakter publik 2. Numri i ankesave të përgjigjura për qasje ndaj informatave me karakter publik

Në tabelën në vijim jepen kriteret për përcaktimin e vlerës dhe notës adekuate për çdo tregues. Vlera e të gjithë treguesve prej 1.1 deri në 3.6 fitohet si raport i dy variableve për treguesin e cekur dhe varësisht nga vlera e fituar, jepet nota e dhënë për treguesin. Për vlerësimin e treguesve 3.7 dhe 4.1-4.3 janë shfrytëzuar kriteret tjera, të prezantuara në Tabelën 6:

Tabela 6: Kriteret për vlerësimin e treguesve të urbanizmit

Definimi i treguesve	Të dhënat sasiore dhe cilësore	KRITERI dhe NOTA				
		1	2	3	4	5
1.1. Bashkëpunimi mes komunës dhe pushtetit qendror	1. Numri i pëlqimeve të pranuar nga ministrët	< 0,2	0,2 – 0,4	0,4 – 0,6	0,6 – 0,8	> 0,8
	2. Numri i pëlqimeve të kërkuara nga ministrët					
1.2. Liria e realizimit të ingjercave	1. Notat e udhëheqësve të sektorëve/seksioneve të urbanizmit dhe kryetarëve të komunave	< 0,2	0,2 – 0,4	0,4 – 0,6	0,6 – 0,8	> 0,8
1.3. Aftësia financiare e komunës për implementimin e planeve urbane	1. Gjithsej të dala kapitale	< 0,10	0,11 – 0,15	0,16 – 0,2	0,21 – 0,3	> 0,31
	2. Gjithsej të dala					
1.4. Shpenzimet kapitale të komunës për kokë banori	1. Gjithsej të dala kapitale	< 500	500 – 1.000	1.000 – 1.500	1.500 – 2.000	> 2.000
	2. Numri i banorëve në komunë					

1.5. Aftësia financiare e komunës për hartimin e planeve urbane	1. Shuma e mjeteve vetanake që komuna i ka shpenzuar për financimin e hartimit të planeve urbane (në denarë)	< 0,2	0,2 – 0,4	0,4 – 0,6	0,6 – 0,8	> 0,8
	2. Gjithsej mjete të shpenzuara për financimin e hartimit të planeve urbane (në denarë)					
1.6. Kapaciteti i komunës për shembjen e objekteve të ndërtuara pa leje	1. Shuma e mjeteve të realizuara për shembjen e objekteve të ndërtuara pa leje (në denarë)	< 0,2	0,2 – 0,4	0,4 – 0,6	0,6 – 0,8	> 0,8
	2. Shuma e mjeteve të parapara për shembjen e objekteve të ndërtuara pa leje (në denarë)					
1.7. Mbulimi i komunës me PGJU, PDU, plan urban për fshatra dhe planet për vendet jashtë lagjeve të banuara	1. Sipërfaqja e komunës që mbulohet me plan urban (ha)	< 0,02	0,02 – 0,04	0,04 – 0,08	0,08 – 0,1	> 0,1
	2. Gjithsej sipërfaqja e komunës (ha)					
1.8. Efikasiteti i lëshimit të ekstrakteve të planeve urbane	1. Numri i ekstrakteve të lëshuara të planit urban (PU)	< 0,3	0,3 – 0,5	0,5 – 0,7	0,7 – 0,9	> 0,9
	2. Numri i kërkesave të parashtruara për ekstrakt të PU					
1.9. Efikasiteti i lëshimit të vendimit për kushtet e lokacionit	1. Numri i vendimeve të lëshuara për kushtet e lokacionit	< 0,3	0,3 – 0,5	0,5 – 0,7	0,7 – 0,9	> 0,9
	2. Numri i kërkesave të parashtruara për kushtet e lokacionit					
1.10. Efikasiteti i lëshimit të lejes për ndërtim	1. Numri i lejeve të lëshuara për ndërtim	< 0,3	0,3 – 0,5	0,5 – 0,7	0,7 – 0,9	> 0,9
	2. Numri i kërkesave të parashtruara për leje ndërtimi					
1.11. Efikasiteti i lëshimit të lejes për shfrytëzim	1. Numri i lejeve të lëshuara për shfrytëzim	< 0,3	0,3 – 0,5	0,5 – 0,7	0,7 – 0,9	> 0,9
	2. Numri i kërkesave të parashtruara për leje për shfrytëzim					
1.12. Performanset e inspeksionit urbanistik dhe ndërtimor	1. Numri i vendimeve të realizuara për shembjen e objekteve të ndërtuara pa leje	< 0,3	0,3 – 0,5	0,5 – 0,7	0,7 – 0,9	> 0,9
	2. Numri i vendimeve të miratuara për shembjen e objekteve të ndërtuara pa leje					
1.13. Inovacioni gjatë zbatimit të injerencave	1. Formularët e fushës së urbanizmit jepen në internet	1. (jo=1; po=2) 2. (jo=0; po=1) 3. (jo=0; po=2=1; >2=2) <u>1+2+3</u>				
	2. Komuna posedon kompjuterët me softuer të licencuar dhe instaluar për GIS					
	3. Komuna ka të punësuar që kanë njohuri për krijimin e bazave të të dhënave dhe prezantimit grafik me GIS softuer					

1.14. Niveli i përfshirjes së qytetarëve në çështjet e planifikimit hapësinor dhe planifikimit urban me karakter lokal	1. Numri i mënyrave për mbledhjen e informatave kthyesë nga qytetarët	1. (nuk ka edhe deri në 2 = 1; >2=2) 2. (jo=0; deri në 2 = 1; >2=3) <u>1+2</u>
	2. Numri i formave të organizuara të pjesëmarrjes së qytetarëve në procedurat e miratimit të PU	
1.15. Llogaridhënia për punën	1. Numri i mënyrave për informimin e qytetarëve për çështjet e fushës së urbanizmit	nuk ka =1; deri në 2=1; 3=3; 4=4; 5=5
1.16. Qasja ndaj informatave të karakterit publik	1. Numri i kërkesave të përgjigjura për qasje ndaj informatave me karakter publik	1. (të gjitha -3, nuk ka kërkesa/pjesërisht -2, asnjë -1) 2. (të gjitha -2, nuk ka kërkesa/pjesërisht -1, asnjë -0) <u>1+2</u>
	2. Numri i ankesave të përgjigjura për qasje ndaj informatave me karakter publik	

2.3.4 Metodologjia e hulumtimit të mendimit të qytetarëve

Një prej mënyrave për përcaktimin e interesave dhe mendimeve të qytetarëve është edhe hulumtimi i mendimit të tyre. Sipas planit, ky hulumtim duhej ta vërtetojë mendimin e qytetarëve, në aspekt të cilësisë së shërbimeve që i ofron komuna e tyre. Në pyetësor përfshihen të gjitha shërbimet komunale, pavarësisht nga faza dhe niveli i decentralizimit të tyre.

Pyetësori është organizuar në **2 pjesë kryesore**. Pjesa 1 e Pyetësorit është përbërë prej **7 fushave**, që përfshijnë **52 pyetje** dhe një pyetje gjenerale për kënaqësinë e qytetarëve me shërbimet, që janë nën ingjierencë komunale.

Në vijim jepen shtatë fushat e Pjesës 1 të Pyetësorit:

- **Arsimi, kultura, sporti dhe rekreacioni (9 pyetje)**
- **Urbanizmi dhe planifikimi urban (7 pyetje)**
- **Zhvillimi ekonomik lokal (6 pyetje)**
- **Mbrojtja sociale (7 pyetje)**

- **Veprimtaritë komunale (12 pyetje)**
- **Demokracia, transparencja dhe llogaridhënia gjatë punës (8 pyetje)**
- **Mbrojtja (3 pyetje)**

Në këtë pjesë, qytetarët e kanë dhënë mendimin e tyre për cilësinë e shërbimeve që i ofron komuna, duke notuar 52 pyetje me notat në vijim: shumë dobët (1), dobët (2), mirë (3), shumë mirë (4) dhe shkëlqyeshëm (5). Të anketuarit që nuk kanë përvojë me ndonjë shërbim të caktuar ose që nuk kanë qenë në mundësi të vlerësojnë, e kanë pasur opsionin e rrethimit të numrit 6 në shkallën e notave.

Në Pjesën 2 të Pyetësorit jepen 9 pyetje, të cilave qytetarët i janë përgjigjur duke e rrethuar numrin para përgjigjes më të afërt me mendimin e tyre.

Në pjesën demografike të Pyetësorit, të anketuarit kanë dhënë përgjigje për gjininë e tyre, moshën, vendin e banimit, llojin e vendbanimit ku jetojnë, përkatësinë etnike dhe komunën ku banojnë.

Ky lloj i pyetësorit është metodë e lehtë dhe jep shumë të dhëna relevante për mendimet e qytetarëve dhe cilësinë e shërbimeve. Dobësia e këtij lloji është që njerëzit mund të japin vlerësim të shërbimit edhe pa pasur përvojë personale. Konkretisht, përgjigjet mund të jenë subjektive dhe të bazohen në percepticionin e përgjithshëm. Për shembull, një qytetar mund të mos ketë shfrytëzuar ndonjë shërbim të caktuar dhe të shprehet si i kënaqur prej shërbimit, madje edhe në raste kur shërbimi në fjalë nuk ekziston aspak.

Hulumtimi është një lloj i pasqyrës së rezultateve të shënuara, nga perspektiva e shfrytëzuesve të shërbimeve komunale, duke i siguruar informata kthyesë komunave për gjërat që funksionojnë si duhet dhe ato që nuk funksionojnë.

Në kuptim të mbështetjes së përpjekjeve të vazhdueshme të komunës për përmirësimin e shërbimeve që i jepen qytetarëve, hulumtimi i ka pasur këto qëllime:

- Marrja e mendimit të qytetarëve për shërbimet e ofruara nga komuna, si pjesë e vëzhgimit të realizimit të decentralizimit në Republikën e Maqedonisë;
- Krijimi i indeksit të kënaqësisë së qytetarëve me cilësinë e shërbimeve, përmes të cilit mund të matet realizimi i shërbimeve komunale;
- Sigurimi i mundësisë për notimin e kënaqësisë së qytetarëve me cilësinë e shërbimeve komunale, si dhe me cilësinë e jetës në komunë;
- Rezultatet e hulumtimit mund të shfrytëzohen gjatë SWOT analizave dhe gjatë caktimit të prioritetëve të sektorëve, qëllimeve, programeve dhe projekteve në proceset e planifikimit strategjik të zhvillimit lokal të komunave;

- Ofrimi i ndihmës në krijimin e kulturës së menaxhimit komunal, të bazuar në "orientimin drejt rezultateve";
- Sigurimi i kanalit të besueshëm për Kryetarin e komunës dhe Këshillin, ku përfshihen prioritetet dhe qëndrimet e ndryshueshme të qytetarëve dhe që mund të përdoren gjatë vendim-marrjes.

Shënjestra e hulumtimit ka qenë në popullatën mbi moshën 18-vjeçare.

Hulumtimi është bazuar në pyetësorin e strukturuar si instrument. Zhvillimi i pyetësorit, shënimi i të dhënave në formë elektronike dhe analiza e të dhënave është realizuar nga QZhdL.

Anketa është realizuar në periudhën 26 nëntor – 8 dhjetor 2010 nga kompania e specializuar e hulumtimeve GfK Research nga Shkupi. Metoda një-me-një është aplikuar në të gjitha intervistat dhe çdonjëra prej tyre është realizuar në amvisëri. Personi i anketuar i amvisërisë dhe amvisëritë janë zgjedhura sipas shortit të rastësishëm.

Për realizimin e punës në terren janë angazhuar gjithsej 45 anketues. Në vijim jepet numri i personave që e kanë realizuar intervistën sipas komunave:

Tabela 7

Komuna	Kumanovë	Tetovë	Gostivar	Karposh	Ohër	Veles	Strumicë
Numri i anketuesve	7	6	6	4	4	4	4

Komuna	Bogovinë	Dibër	Negotinë	Ilinden	Staro Nagoriçane	Gjithsej
Numri i anketuesve	2	2	2	2	2	45

Masa dhe profili i ekzemplarit të të anketuarve jepet në vijim.:

Tabela 8

Komuna	Urbane	Rurale	Gjithsej
Kumanovë	186	84	270
Tetovë	173	57	230
Gostivar	166	64	230
Karposh	150	10	160
Ohër	123	37	160
Veles	122	38	160
Strumicë	125	35	160
Bogovinë	0	90	90
Dibër	65	15	80
Negotinë	55	25	80
Ilinden	0	70	70
Staro Nagoriçane	0	65	65
Gjithsej	1.165	590	1.755

Gjatë analizës së rezultateve të hulumtimit, përveç numrit në përgjithësi, janë analizuar edhe rezultatet sipas gjinisë, grupit të moshës (katër grupe: 18-25 vjeç, 26-45 vjeç, 46-65 vjeç dhe mbi 65 vjeç), sipas vendit ku banojnë (dy grupe: urbane dhe rurale) dhe sipas përkatësisë etnike (maqedonas, shqiptarë, tjerë).

Përgjigjet janë analizuar duke i aplikuar metodat në vijim:

- Për pjesën e parë kryesore të përgjigjeve të Pyetësorit, është aplikuar Shkalla e Likertit me vlerë 1-6, ku indeksi i kënaqësisë së qytetarëve IKQsh (sh-shërbimi konkret që e

jep komuna) është llogaritur në bazë të formulës në vijim:

Indeksi i kënaqësisë së qytetarëve me shërbimin (shërbimi konkret) =
(numri i përgjigjeve "Shumë dobët" x 1 + numri i përgjigjeve "Dobët" x
2 + numri i përgjigjeve "Mirë" x 3 + numri i përgjigjeve "Shumë mirë" x
4 + numri i përgjigjeve "Shkëlqyeshëm" x 5 / numri total i përgjigjeve

$$IKQsh = \frac{(NP_{SHD} \times 1 + NP_D \times 2 + NP_M \times 3 + NP_{SHM} \times 4 + NP_{SH} \times 5)}{(NP_{SHD} + NP_D + NP_M + NP_{SHM} + NP_{SH})}$$

IKQsh - indeksi i kënaqësisë së qytetarëve me shërbimin (shërbimi konkret)

NP_{SHD} - numri i përgjigjeve "Shumë dobët"

NP_D - numri i përgjigjeve "Dobët"

NP_M - numri i përgjigjeve "Mirë"

NP_{SHM} - numri i përgjigjeve "Shumë mirë"

NP_{SH} - numri i përgjigjeve "Shkëlqyeshëm"

- Ata që nuk janë përgjigjur, si dhe ata që e kanë dhënë notën 6 – nuk kanë përvojë me shërbimin e dhënë ose nuk mund ta vlerësojnë atë. Këto janë përjashtuar nga rangimi ose përqindja.
- Me qëllim të prezantimit më praktik të analizave të caktuara, është aplikuar metoda "Kënaqshëm" dhe "Pakënaqshëm"

$$\text{"Pakënaqshëm"} = \frac{(NP_{SHD} + NP_D)}{(NP_{SHD} + NP_D + NP_M + NP_{SHM} + NP_{SH})} (\%)$$

$$\text{"Kënaqshëm"} = \frac{(NP_M + NP_{SHM} + NP_{SH})}{(NP_{SHD} + NP_D + NP_M + NP_{SHM} + NP_{SH})} (\%)$$

Të dhënat janë analizuar duke e përdorur bazën e të dhënave dhe formulat gjegjëse të Microsoft Excel 2007.

Në tabelat në vijim jepen të dhënat demografike të të anketuarve në 12 komunat:

- 50,03% e të anketuarve janë meshkuj, kurse 49,80% femra.
- 22,85% e të anketuarve janë në moshën 18-25; 43,15% janë në grup-moshën prej 26 deri në 45-vjeç; 28,31% janë mes 46 dhe 65-vjeç dhe 3,64% janë mbi moshën
- 65-vjeçare.
- 66,12% e të anketuarve jetojnë në mjedis urban, kurse 33,37% janë shprehur që jetojnë në mjedis rural.
- 71,12% e të anketuarve janë shprehur që e konsiderojnë veten maqedonas, 23,14% shqiptarë dhe 5,12% – tjerë (më së shumti serbë).

Mendimet	Gjithsej të anketuar sipas kategorive					Gjithsej të anketuar sipas kategorive në %				
	Σ"1"	Σ "2"	Σ "3"	Σ "4"	Pa përgjigje	Σ"1"	Σ "2"	Σ "3"	Σ "4"	Pa përgjigje
Gjinia 1=M 2=F	880	876			3	50,03%	49,80%			0,17%
Mosha 1=Prej 18 deri 25 vjeç 2= Prej 26 deri 45 vjeç 3= Prej 46 deri 65 vjeç 4=Mbi 65 vjeç	402	759	498	64	36	22,85%	43,15%	28,31%	3,64%	2,05%
Vendbanimi 1=Mjedisi urban (qytet) 2= Mjedisi rural (fshat)	1.163	587			9	66,12%	33,37%			0,51%
Përkatësia etnike 1=Maqedonas 2=Shqiptar 3=Tjetër	1.251	407	90		11	71,12%	23,14%	5,12%		0,63%

KAPITULLI 3. ANALIZA E REZULTATEVE TË VIJIMIT TË PROCESIT TË DECENTRALIZIMIT PËR PERIUDHËN 2008 – 2009

3.1 Financat


3.1.1 Indeksi i decentralizimit fiskal (IDF)

Indeksi i decentralizimit fiskal (IDF) për vitin 2008 është 2,96, kurse gjatë vitit 2009 është zvogëluar në 2,81. Mesatarisht, ka rënie për 6%. Në vijim jepen nën-indekset dhe faktorët e rëndësisë që e formojnë IDF-në, posaçërisht për vitin 2008 dhe 2009:

	Nën-indekset (NI)		Faktori i rën- dësisë	2008	2009
1.	Implementimi i politikave të decentralizimit fiskal	NI 1	28%	2,84	2,64
2.	Gjendja financiare e NJVL-së	NI 2	37%	2,89	2,64
3.	Gjendja e përgjithshme ekonomike e komunës	NI 3	21%	2,97	2,97
4.	Transparenca dhe llogaridhënia	NI 4	14%	3,36	3,36
IDF				2,96	2,81


Si që shihet në tabelë, secili nën-indeks merr pjesë me peshë (rëndësi) të ndryshme në formimin e IDF-së. Gjegjësisht, në bazë të mendimit të nëpunësve shtetërorë përgjegjës dhe të kryetarëve të komunave-partnere, peshë dhe rëndësi më të madhe ka nën-indeksi i gjendjes financiare të NJVL-së, kurse peshë më të vogël ka indeksi i transparencës dhe llogaridhënies, që shihet në grafikun në vijim:

Faktorët e peshës (rëndësisë) në IDF




28% - NI1
37% - NI2
21% - NI3
14% - NI4

Në mënyrë individuale, vlera e secilit nën-indeks që e formojnë IDF-në për vitin 2008 dhe 2009 shfaqet në grafikun në vijim:




Krahasimi i nën-indekseve të IDF-së për vitin 2008 dhe 2009

Prej 12 komunave të vëzhguara në vitin 2008: 5 kanë pasur vlerë më të ulët, kurse 7 kanë qenë nën vlerën mesatare të IDF-së për 12 komunat. Në vitin 2009, 4 kanë pasur vlerë më të madhe, 2 vlerë të ngjashme me vlerën mesatare, kurse 6 kanë pasur IDF më të ulët se vlera mesatare e IDF-së për 12 komunat. Grafiku në vijim e prezanton këtë:



Grafiku në vijim i shfaq vlerat e indekseve të IDF-së për çdonjërin prej 12 komunave, në mënyrë paralele për vitin 2008 dhe 2009. Qendra e tregon vlerën 1 të nën-indeksit, që rritet drejt periferisë me vlerë maksimale 5.




Në vijim jepet përshkrimi i detajuar i çdo nën-indeksi dhe treguesve që e formojnë nën-indeksin konkret. Në fillim jepet përshkrimi i secilit tregues, kurse pastaj edhe nota mesatare e të gjitha komunave, sipas kriterëve të prezantuar paraprakisht në tekst.

3.1.2 Nën-indeksi i zbatimit të politikave

Faktori i rëndësisë së këtij nën-indeksi është 28/100, që do të thotë se ky nën-indeks merr pjesë me 28% të peshës në vlerën totale të IDF-së. Vlerat e rëndësisë së çdo treguesi të nën-indeksit jepen në grafikun në vijim, ku shihet që rëndësi (peshë) më të madhe ka treguesi 1.2, që ka të bëjë me pjesëmarrjen e të hyrave në buxhetin

themelor ndaj totalit të të hyrave të komunës (25%). Pjesëmarrje më të vogël ka treguesi 1.6 (10%), që ka të bëjë me pjesëmarrjen e mjeteve themelore në financimin e programeve/fushave (rugët, arsimi, mbrojtja sociale, mbrojtja kundër zjarrit, komunalet, kultura, sporti, etj)

Faktorët e peshës (rëndësisë) indikatorëve në NI 1



Në tabelën në vijim jepet vlera e këtij nën-indeksi dhe faktorët që e formojnë, së bashku me notat gjegjëse mesatare të komunave të analizuar në vitin 2008 dhe 2009. Më poshtë jepet edhe përshkrimi i detajuar i treguesve. Vlera e këtij nën-indeksi është zvogëluar prej 2,81 (2008) në 2,64 në vitin 2009.

2008			TREGUESI	2009		
NI 1	Vlera e mesme e treguesit	Nota e mesme e treguesit		Nota e mesme e treguesit	Vlera e mesme e treguesit	NI 1
2,84	0,14	3,18	1.1. Pjesëmarrja e të dalave komunale në totalin e shpenzimit publik të RM-së për kokë banori	3,09	0,14	2,64
	0,37	2,45	1.2. Pjesëmarrja e të hyrave në buxhetin themelor ndaj totalit të të hyrave	2,36	0,35	
	0,22	3,09	1.3. Niveli i autorizimit për vendim-marrje vetanake	3,27	0,22	
	0,21	3,27	1.4. Kontrolli lokal mbi transferet e pushtetit qendror	2,55	0,17	
	0,19	2,73	1.5. Pjesëmarrja e të dalave kapitale në totalin e të dalave	2,27	0,14	
	1,41	2,73	1.6. Pjesëmarrja e mjeteve vetanake në financimin e programeve/fushave (rugët, arsimi, mbrojtja sociale, mbrojtja kundër zjarrit, komunalet, kultura, sporti, etj)	2,55	1,30	

Treguesi 1.1: Pjesëmarrja e të dalave të komunave në totalin e shpenzimit publik në RM, për kokë banori

Ky tregues tregon sa të larta janë të dalat për kokë banori nga buxheti komunal, në krahasim me të dalat për kokë banori nga buxheti i Republikës së Maqedonisë. Të dhënat fitohen kur totali i të dalave komunë/banor pjesëtohet me totalin e të dalave të buxhetit të RM/banor. Sa më e lartë është vlera, aq më e lartë është nota e treguesit. Faktori i rëndësisë është 11%.

Në dy vitet e analizuara (2008 dhe 2009), vlera e treguesit ka qenë 0,14, që do të thotë se mesatarisht, të dalat për kokë banori në

komunat e analizuara kanë qenë 14%, krahasuar me të dalat e buxhetit të RM-së, për kokë banori. Duke marrë parasysh që në këtë analizë janë përfshirë 12 nga gjithsej 84 komuna (14,3%), në të cilat jetojnë rreth 590.000 ose 29% e banorëve të shtetit, mund të përfundohet që kjo përqindje do të kishte qenë edhe më e vogël, në qoftë se hulumtimi i përfshin të gjitha 84 komunat. Notat mesatare për këtë tregues janë 3,18 (2008), gjegjësisht 3,09 (2009).

Praktikisht, komunat e analizuar shpenzojnë 7 herë më pak të holla në krahasim me shtetin. Ky raport do të jetë edhe më i pavoritshëm për komunat, nëse analizohen të gjitha 84 komunat.

Treguesi 1.2: Pjesëmarrja e të hyrave të buxhetit themelor në raport me totalin e të hyrave të komunës

Ky tregues e tregon pjesën e të hyrave të komunës që janë të hyra në buxhetin themelor, duke u logaritur si raport i të hyrave të buxhetit themelor dhe totalit të të hyrave. Sa më e lartë të jetë kjo vlerë, aq më e lartë është nota e treguesit. Faktori i rëndësisë i këtij treguesi është 25% dhe ka rëndësi më të madhe në përcaktimin e vlerës së nën-indeksit 1 në IDF.

Për vitin 2008, vlera e treguesit është 0,37, që do të thotë se vetëm 37% e të hyrave totale të komunës janë të hyra të buxhetit themelor. Në vitin 2009, vlera është ulur në 35%. Notat mesatare të këtij treguesi janë 2,45 (2008) dhe 2,36 (2009).

Kjo do të thotë që komunat mund të vendosin vetë për shpenzimin e vetëm 35% të mjeteve themelore të buxhetit komunal. Për 65% tjera, komunat janë një lloj i "orientuesit" që i orienton mjetet tek institucionet gjegjëse.

Treguesi 1.3: Niveli i autorizimeve për vendim-marrjen e komunave

Ky tregues tregon sa e pavarur është komuna në përcaktimin e nivelit të tarifave dhe kompensimeve. Treguesi fitohet me pjesëtimin e të hyrave për të cilat komuna i cakton tarifën e kompensimeve/taksave dhe totalin e të hyrave të komunës (gjithsej buxheti). Sa më i madh është ky raport, aq më e lartë është nota e treguesit. Faktori i rëndësisë së këtij treguesi është 19%.

Për dy vitet e analizuar, vlera e treguesit është 0,22, që do të

thotë se mesatarisht, komunat e analizuar vendosin vetëm dhe e caktojnë shumën e kompensimeve/taksave dhe tarifave gjegjëse për vetëm 22% nga gjithsej të hyrat. Notat mesatare për këtë tregues janë 3,09 (2008) dhe 3,27 (2009).

Praktikisht, kjo do të thotë që komunat aspak nuk mund të vendosin në mënyrë të pavarur për 78% të të hyrave të buxhetit komunal.

Treguesi 1.4: Kontrolli lokal mbi transferet e pushtetit qendror

Ky tregues e tregon nivelin e pavarësisë së komunës, në aspekt të shpenzimit të mjeteve të fituara përmes transfereve të pushtetit qendror. Treguesi fitohet si raport i transfereve në buxhetin themelor dhe total transfereve. Sa më i madh të jetë ky raport, aq më e madhe është nota e treguesit. Faktori i rëndësisë së këtij treguesi është 12%.

Në vitin 2008, vlera e treguesit ka qenë 0,21, që do të thotë se vetëm 21% e të hyrave përmes transfereve janë transferet në buxhetin themelor. Vlera është zvogëluar në 17% në vitin 2009. Notat mesatare të këtij treguesi janë 3,27 (2008) dhe 2,55 (2009).

Këto të dhëna tregojnë që komunat kanë mundur të vendosin për shpenzimin e vetëm 21% (në 2008) dhe 17% (në 2009) të mjeteve të fituara përmes transfereve. Pjesa tjetër (80%) e mjeteve të transfereve mbeten si "mjete të dedikuara" ndonëse pjesa më e madhe janë bllok-dotacione.

Treguesi 1.5: Pjesëmarrja e të dalave kapitale në totalin e të dalave

Ky tregues tregon sa prej totalit të të dalave komunale dedikohen për të dalat kapitale. Fitohet si raport i totalit të të dalave dhe gjithsej të dalave. Sa më i madh është raporti, aq më e madhe është nota e treguesit. Faktori i rëndësisë së këtij treguesi është 23%.

Për vitin 2008, vlera e treguesve ka qenë 0,19, kurse në vitin 2009 është zvogëluar dhe është ulur në 0,14. Kjo do të thotë që komunat e analizuar kanë shpenzuar 19% për investime kapitale në vitin 2008 dhe vetëm 14% në vitin 2009. Notat mesatare për këtë tregues janë 2,73 (2008) dhe 2,27 (2009).

Praktikisht, kjo do të thotë që mesatarisht, mbi 85% e buxheteve të analizuar shpenzohen për shpenzime rrjedhëse, rroga dhe kontribute. Për investime kapitale shpenzohen vetëm 15%.

ITreguesi 1.6: Pjesëmarrja e mjeteve vetanake në financimin e programeve/ fushave

Ky tregues e tregon masën e mjeteve vetanake plotësuese, me të cilat komuna merr pjesë në financimin e programeve të fushave të ndryshme (rugë, arsim, mbrojtje sociale, mbrojtje nga zjarri, komunalet, kultura, sporti, etj) dhe fitohet si raport i gjithsej të dalave sipas fushave/programeve dhe gjithsej transfereve të pushtetit qendror për këto fusha/programe. Sa më i madh është raporti, aq më e madhe është nota e treguesit. Faktori i rëndësisë së këtij treguesi është 10%.


Për vitin 2008, vlera e treguesve ka qenë 1,41, që do të thotë se komunat kanë investuar si plotësim 41% të mjeteve vetanake, në krahasim me mjetet e fituara nga pushteti qendror për financimin e programeve të fushave të ndryshme. Vlera është zvogëluar në 30% në vitin 2009. Notat mesatare për këtë tregues janë 2,73 (2008) dhe 2,55 (2009).

Këto të dhëna tregojnë që (1) ose komunat në vitin 2009 kanë pasur më pak mjete që mund t'i dedikojnë për programet e fushave të ndryshme, (2) ose janë rritur mjetet e pranuar nga pushteti qendror për këto programe. Sidoqoftë, të dy variantet janë negative për decentralizimin si proces.

3.1.3 Nën-indeksi i gjendjes financiare të NJVL-ve

Faktori i rëndësisë së këtij nën-indeksi është 37/100, që do të thotë se ky nën-indeks merr pjesë me 37% në vlerën totale të IDF-së. Kjo do të thotë që sipas mendimit të nëpunësve përgjegjës shtetërorë dhe kryetarëve të komunave-partnere, ky nën-indeks e shfaq faktorin më të rëndësishëm të decentralizimit të suksesshëm fiskal. Vlerat e rëndësisë për secilin tregues që e formojnë këtë nën-indeks jepen në grafikun në vijim. Ato tregojnë që rëndësi ose peshë më të madhe ka treguesi 2.3, që ka të bëjë me të dalat lokale sipas artikujve ekonomikë (25%). Rëndësi më të vogël ka treguesi 2.6 (10%), që ka të bëjë me të hyrat e NJVL-së për banor:

Faktorët e peshës (rëndësisë) në NI 2



Në vijim shfaqet vlera e këtij nën-indeksi dhe treguesve që e formojnë atë, së bashku me vlerat gjegjëse mesatare për të gjitha komunat e analizuar në vitin 2008 dhe 2009. Më poshtë jepet edhe përshkrimi i detajuar për çdo tregues. Vlera e këtij nën-indeksi është zvogëluar prej 2,89 (2008) në 2,64 (2009).

2008			TREGUESI
NI 2	Vlera e mesme e treguesit	Nota e mesme e treguesit	
2,89	0,06	1,73	2.1. Balanci vjetor financiar (rezerva)
	1.894	3,82	2.2. Të dalat kapitale të komunës për banor
	0,28	2,64	2.3. Të dalat lokale sipas artikujve ekonomikë
	0,26	2,45	2.4. Disponueshmëria e të dalave operative
	1,43	3,00	2.5. Struktura e të hyrave
	9.940	4,09	2.6. Të hyrat e NJML-së për banor

2009			TREGUESI
NI 2	Vlera e mesme e treguesit	Nota e mesme e treguesit	
2,64	0,06	2,09	2.1. Balanci vjetor financiar (rezerva)
	1.503	3,45	2.2. Të dalat kapitale të komunës për banor
	0,21	2,00	2.3. Të dalat lokale sipas artikujve ekonomikë
	0,21	2,00	2.4. Disponueshmëria e të dalave operative
	1,38	2,91	2.5. Struktura e të hyrave
	10,670	4,27	2.6. Të hyrat e NJML-së për banor

Treguesi 2.1: Balanci vjetor financiar (rezerva)

Ky tregues e jep balancin vjetor të komunës, gjegjësisht tregon nëse të hyrat janë të mjaftueshme për mbulimin e të dalave të komunës. Llogaritet si raport mes dalimit të totalit të të hyrave dhe dalave vjetore dhe gjithsej të dalave vjetore. Sa më i madh është ky raport, aq më e madhe është nota e treguesit. Faktori i rëndësisë së këtij faktori është 12%.

Në vitin 2008, si dhe në vitin 2009, vlera e treguesit është 0,06, që do të thotë se komunat mesatarisht kanë pasur rezervë prej 6%. Kjo do të thotë që totali i të dalave mbulohet tërësisht me të hyrat e realizuara nga komunat. Sipas kriterëve të caktuara, notat janë 1,73 (2008) dhe 2,09 për vitin 2009.

Praktikisht, duke e marrë parasysh që komunat aspak nuk kanë marrë borxhe (ose kanë marrë shumë pak) në tregun e kapitalit, kjo do të thotë që mesatarisht, të dalat janë planifikuar në mënyrë adekuate dhe plotësisht janë mbuluar nga të hyrat e realizuara.

Treguesi 2.2: Të dalat kapitale të komunës për banor

Ky tregues e jep vlerësimin e nivelit të investimeve kapitale në komunë, për kokë banori. Treguesi fitohet si përpjesëtim i totalit të të dalave kapitale dhe numrit të banorëve në komunë. Sa më i madh është ky raport, aq më e madhe është vlera e treguesit.

Në vitin 2008, vlera mesatare e treguesit ka qenë 1.894 MKD/banor, kurse në vitin 2009 është zvogëluar në 1.503 MKD/banor. Notat mesatare për këtë tregues janë 3,82 (2008) dhe 3,45 (2009). Për krahasim, investimet kapitale të buxhetit të RM-së për kokë banori në vitin 2008 dhe 2009 janë rreth 9.700 MKD/banor.

Kjo tregon që komunat kanë investuar 6 herë më pak mjete për kokë banori në investimet kapitale, krahasuar me shtetin. Në komunat e analizuara, investimet kapitale për kokë banori në vitin 2009 janë zvogëluar për rreth 20%, krahasuar me vitin 2008.

Treguesi 2.3. Të dalat lokale sipas artikujve ekonomikë

Ky tregues e tregon komponentin zhvillimor të buxhetit komunal. Gjegjësisht, treguesi e shfaq pjesën e buxhetit që shpenzohet për nevoja zhvillimore. Treguesi fitohet si raport i artikujve të shpenzimeve zhvillimore (46+47+48) dhe artikujve operative-administrative

(40+41+42). Sa më i madh të jetë ky raport, aq më e madhe është nota e treguesit. Faktori i rëndësisë së këtij treguesi është 25% dhe ka rëndësi më të madhe në caktimin e vlerës së nën-indeksit.

Për vitin 2008, vlera e treguesit është 0,28, që do të thotë se 28% e buxhetit duhet të trajtohet si "zhvillimor", kurse pjesa tjetër shpenzohet për të dalat operative-administrative. Në vitin 2009, vlera është ulur në 21%. Notat për këtë tregues janë 2,64 (2008) dhe 2,00 (2009).

Përfundohet që artikujt e shpenzimeve zhvillimore në vitin 2009 janë ulur për mbi 25%, në llogari të artikujve operative-administrativë, që do të thotë se komunat në vitin 2009 kanë pasur më pak mjete financiare për nevojat zhvillimore, krahasuar me vitin 2008.

Treguesi 2.4. Disponueshmëria e të dalave operative

Ky tregues e tregon raportin e të a.q. të hyrave operative (tatimore dhe jotatimore) dhe totalit të të hyrave të komunës në nivel vjetor. Sa më i madh është ky raport, aq më e madhe është nota e treguesit. Faktori i rëndësisë i treguesit është 17%.

Në vitin 2008, vlera e treguesit ka qenë 0,26, që do të thotë se 26% e totalit të të dalave vijnë nga të hyrat tatimore dhe jotatimore. Në vitin 2009, kjo përqindje ka rënë në 21%. Notat e treguesit janë 2,45 (2008) dhe 2,00 (2009).

Duke i konsideruar të dalat kapitale të vogla të komunave, rezultatet tregojnë që transferet dhe donacionet kanë pasur rol më dominues në vitin 2009, që e nënkupton edhe varshmërinë më të madhe financiare nga pushteti qendror.

Treguesi 2.5. Struktura e të hyrave

Ky tregues e shfaq pjesën e të hyrave totale të komunës që vijnë nga transferet dhe donacionet. Treguesi fitohet si raport i totalit të të hyrave dhe të hyrave nga transferet dhe donacionet. Sa më i madh është ky raport, aq më e madhe është nota e treguesit. Faktori i rëndësisë së faktorit është 22%.

Për vitin 2008, vlera e treguesit është 1,43 që do të thotë se të dalat totale kanë qenë për 43% më shumë se transferet. Në vitin 2009, kjo përqindje është ulur në 38%, gjegjësisht të hyrat totale kanë qenë për 38% më të larta se transferet. Notat e indikatorëve janë 3,00 (2008) dhe 2,91 (2009).

Kjo do të thotë që në vitin 2009, të hyrat nga transferet në buxhetin e komunës janë rritur, në krahasim me vitin 2008. Si që ka treguar treguesi 2.4, në vitin 2009 komunat kanë qenë më të varura nga pushteti qendror në aspektin financiar.

Treguesi 2.6. Të hyrat për kokë banori

Ky tregues e jep raportin e të hyrave totale në buxhetin e komunës dhe numrit të banorëve të komunës. Sa më i madh është ky raport, aq më e madhe është nota e treguesit. Faktori i rëndësisë së këtij treguesi është 10%.


Për vitin 2008, vlera e treguesit është mesatarisht 9.940 MKD/banor, kurse në vitin 2010 vlera është 10.670 MKD/banor. Notat e këtij treguesi janë 4,09 (2008) dhe 4,27 (2009).

Praktikisht, në shumë absolute vërehet rritje e të hyrave për kokë banori në vitin 2009, krahasuar me vitin 2008. Por, nëse merret parasysh që inflacioni në vitin 2009 ka qenë 8,3% (gjegjësisht, të hyrat reale është dashur të jenë 10.765 MKD/banor për të qenë në nivelin e 2008), del që të hyrat e vitit 2009 realisht janë zvogëluar.

3.1.4 Nën-indeksi i gjendjes së përgjithshme ekonomike të komunës

Faktori i rëndësisë së këtij nën-indeksi është 21/100, që do të thotë se ky nën-indeksi merr pjesë me 21% në vlerën totale të IFD-së. Duke e marrë parasysh natyrën e treguesve që hyjnë në këtë nën-indeksi, të dhënat dhe notat e komunave janë identike për vitin 2008 dhe 2009. Vlerat e rëndësisë së secilit tregues që e formojnë këtë nën-indeksi jepen në grafikun në vijim, ku shihet që të gjithë tre treguesit kanë rëndësi përafërsisht të njëjtë. Megjithatë, rëndësi më të madhe (37%) ka treguesi 3.3, që ka të bëjë me të hyrat për amvisëri:

Faktorët e peshës (rëndësisë) në NI 3



Këtu duhet të ceket që NJML-të realisht kanë mundësi shumë të vogla dhe të kufizuara për të ndikuar në përmirësimin e gjendjeve të prekura me treguesit e kësaj fushe, që kryesisht varen nga gjendja e përgjithshme ekonomike në nivel shtetëror.

Në vijim prezantohet vlera e këtij nën-indeksi dhe treguesit që e formojnë atë, së bashku me notat gjegjëse mesatare të të gjitha komunave për vitin 2008 dhe 2009. Më poshtë jepet edhe përshkrimi i detajuar i secilit tregues.

TREGUESI	2008 dhe 2009		
	Nota e mesme e treguesit	Vlera e mesme e treguesit	NI 3
3.1. Niveli i papunësisë	2,64	0,44	2,97
3.2. Niveli i varfërisë	2,64	0,39	
3.3. Të hyrat për amvisëri	3,55	15.123	

Treguesi 3.1. Niveli i papunësisë

Ky tregues e tregon nivelin e papunësisë dhe zakonisht llogaritet si raport mes numrit të personave të papunësuar dhe numrit të popullatës aktive ekonomike.

Në komunat-partnere të analizuar, niveli i papunësisë është 44% dhe është më i lartë se niveli mesatar shtetëror, që sipas të dhënave zyrtare, është rreth 32%. Nota gjegjëse mesatare për të gjitha komunat-partnere është llogaritur të jetë 2,64.

Në përgjithësi, papunësia është më e lartë në komunat rurale që janë analizuar, kurse pak më e vogël në komunat urbane. Niveli më i ulët është shënuar në komunat e Qytetit të Shkupit.

Treguesi 3.2. Niveli i varfërisë

Ky tregues e jep numrin e popullatës së varfër, që përcaktohet sipas të dhënave zyrtare të Entit statistikor për vitin 2010. Fatkeqësisht, këto të dhëna nuk jepen ndaras për çdo komunë, por kategorizohen në tre grupe: komunat rurale, urbane dhe komunat e Qytetit të Shkupit. Vlerat mesatare për nivelin e varfërisë jepen sipas llojit të komunës. Në bazë të këtyre të dhënave, niveli i varfërisë në komunat rurale është 48%, në komunat urbane është 39,2%, kurse në komunat e Qytetit të Shkupit është 12,8%. Në bazë të dhënave të cekura nota për këtë tregues është 2,64.

Vlera mesatare e nivelit të varfërisë në komunat e analizuar është 39% dhe kjo është në kornizat e vlerës mesatare të Maqedonisë, për komunat urbane.

Treguesi 3.3. Të hyrat për amvisëri

Ky tregues e jep vlerën e llogaritjes për të hyrat e amvisërisë, ndonëse nuk matet direkt. Janë përdorur të dhënat e Entit shtetëror statistikor, për numrin e amvisërive, numrin e të punësuarve dhe rrogën mesatare të paguar në Maqedoni, që në gusht 2010 ka qenë në shumë prej 20.541 MKD.


Sipas këtyre të dhënave, të hyrat mesatare për amvisëri në komunat e analizuar janë në shumë prej 15.123 MKD, që është më pak se mesatarja në nivel shtetëror. Nota mesatare e komunave të analizuar është 3,55.

Edhe këtu, të hyrat më të ulëta mesatare janë në komunat rurale. Në komunat urbane janë pak më të larta, kurse në komunat e Qytetit të Shkupit janë më të lartat.

3.1.5 Nën-indeksi i transparencës dhe llogaridhënies

Faktori i rëndësisë së këtij nën-indeksi është 14/100, që do të thotë se ky nën-indeks merr pjesë me 14% të peshës në vlerën totale të IDF-së. Kjo nënkupton që sipas mendimit të nëpunësve përgjegjës shtetërorë dhe sipas kryetarëve të komunave-partnere, ky nën-indeks është faktori me rëndësi më të ulët në decentralizimin e suksesshëm fiskal. Në vijim jepen vlerat e peshës së çdo treguesi që e formojnë këtë nën-indeks, ku sipas grafikut shihet që rëndësi (peshë) më të madhe ka treguesi 4.1, që lidhet me dispozicionin e informatave për buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të komunës (39%). Rëndësi më të vogël ka treguesi 4.3 për qasjen ndaj informatave të karakterit publik (29%).

Faktorët e peshës (rëndësisë) në NI 4



Në tabelën në vijim jepen vlerat e këtij nën-indeksi dhe treguesve që e formojnë atë, së bashku me notat mesatare për të gjitha komunat e analizuara për vitin 2008 dhe 2009. Më poshtë jepet edhe përshkrimi i detajuar i të gjithë treguesve.

Treguesi	Nota mesatare e treguesit	NI 4
4.1. Qasja ndaj informatave për buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të komunës	3,73	3,36
4.2. Llogaridhënia gjatë punës	2,91	
4.3. Qasja ndaj informatave të karakterit publik	3,36	

Treguesi 4.1. Qasja ndaj informatave për buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të komunës

Ky tregues e përfshin formën dhe mënyrat në të cilat qytetarëve i jepen informatat për buxhetin dhe llogarinë përfundimtare, ekzistimin ose mosekzistimin e procedurave zyrtare (të miratuara me vendim të Këshillit ose Kryetarit të komunës), si dhe format e pjesëmarrjes së qytetarëve në krijimin e buxhetit komunal.

Sipas gjendjes së konstatuar në komunat-partnere dhe kriteret e definuara paraprakisht të treguesit, nota mesatare e komunave të analizuara është 3,73.

Këto janë përfundimet e përgjithshme për këtë tregues:

1. Të gjitha komunat sigurojnë forma dhe mënyra për informimin e qytetarëve mbi të dhënat e lidhura me buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të komunës. Mbi 50% e komunave sigurojnë më shumë se 2 mënyra të ndryshme për informim (media lokale, tribuna publike, ueb-faqe, etj), kurse 50% sigurojnë deri në 2 mënyra të ndryshme për informim.

3. Në 5 prej 12 komunave të analizuara (41%), ekzistojnë procedura zyrtare (të miratuara nga Këshilli ose me vendim të Kryetarit të komunës) për mënyrën në të cilën qytetarët njihen me planifikimin dhe realizimin e buxhetit komunal.

3. 10 prej 12 komunave (83%) sigurojnë më shumë se dy forma për pjesëmarrjen e qytetarëve në krijimin e buxhetit komunal (tribuna publike, tubime të qytetarëve, shpallje të thirrjeve për parashtrimin e propozimeve, komunikime direkte me të punësuarit e NJVL-së dhe anëtarët e Këshillit, etj).

Treguesi 4.2. Llogaridhënia gjatë punës

Llogaridhënia gjatë punës përcaktohet përmes disa të dhënave, përfshirë edhe: nëse komuna ka emëruar auditor intern, nëse janë krijuar procedura plotësuese zyrtare për auditim intern financiar, si dhe nëse raportet e auditorëve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm (Enti shtetëror për auditim) janë në dispozicion publik (gazeta zyrtare, internet faqet e komunës, tabelat e shpalljeve, etj).

Sipas gjendjes së konstatuar dhe në bazë të kriterëve të definuara paraprakisht, nota mesatare e të gjitha komunave-partnere për këtë tregues është 2,91. Përfundimi i përgjithshëm jepet në vijim:

1. Të gjitha 12 komunat kanë emëruar auditorë të brendshëm, por vetëm 4 prej tyre kanë përcaktuar dhe krijuar procedura ligjore për auditim financiar të brendshëm dhe të jashtëm.

2. Gjithsej 10 komuna i janë nënshtruar auditimit të Entit shtetëror për auditim (ESHA) në vitin 2008 dhe 2009. Vetëm 5 prej tyre i kanë publikuar Raportet përfundimtare të ESHA-s në ueb-faqet e komunave.

Treguesi 4.3. Qasja ndaj informatave me karakter publik

Ky tregues e përcakton nivelin e dispozicionit të informatave me karakter publik dhe përcaktohet në bazë të parametrevë në vijim: numri i kërkesave të përgjigjura për dispozicion të informatave me karakter publik, nëse komuna i është nënshtruar ESHA-s në vitin 2008 ose 2009, si dhe dispozicioni i dokumentacionit të auditimit të realizuar financiar të ESHA-s.

Në bazë të gjendjes së konstatuar dhe sipas kriterëve të definuara paraprakisht për këtë tregues, nota mesatare e të gjitha komunave-partnere është 3,36.

Do të thotë, komunat kanë marrë shumë pak kërkesa për dispozicionin e informatave me karakter publik në pjesën e financave. Në pjesën më të madhe, kërkesave i janë përgjigjur në afatin ligjor, që e tregon faktin se qytetarët njihen shumë pak me instrumentet për qasje ndaj informatave me karakter publik.


3.2 Arsimi

3.2.1 Performanset e decentralizimit në fushën e arsimit (PDFA)

Pas vitit 2002, kur u miratua Ligji për vetëqeverisje lokale, arsimi ishte një prej injierencave të para që u transferuan nga niveli qendror në nivelin lokal. Përveç bartjes formale të funksionit themelor dhe administrativ të shkollave, në gjysmën e dytë të vitit 2005, komunat i pranuan edhe dotacionet e para të dedikuara për arsim, me çka filloi edhe sistemi i ri ndër-qeveritar për financimin e injierencave, në rrethana të pushtetit të decentralizuar.


Ky vëzhgim e përcjell gjendjen në arsim gjatë vitit 2008 dhe 2009, përmes matjes së nivelit të përgjithshëm të realizimit të injierencave, që shprehet përmes **indeksit për performanset e decentralizimit në arsim – PDFA**. Në kuadër të analizës tonë, ky indeks është matur për secilën komunë ndaras (gjithsej 12), si PDFA lokale. Pastaj, është llogaritur edhe PDFA në nivel të Republikës së Maqedonisë.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë që PDFA në nivel të RM-së në vitin 2008 ka qenë 3,39, kurse në vitin 2009 ka shënuar rritje të vogël në 3,49. Rangu i vlerësimit ka qenë prej 1 deri në 5. Grafiku në vijim i tregon vlerat e PDFA-së për dy vitet:




Lëvizja pozitive e indeksit është shenjë e mirë për zhvillimin e gjërave në praktikimin e decentralizuar të fushës së arsimit, veçanërisht në kuptim të zvogëlimit të dy indekseve tjera, që maten me këtë vëzhgim. Megjithatë, kjo rritje nuk ka shprehje të lartë në përqindje dhe është në nivelin 2,87%.

Prej 12 komunave të vëzhguara në vitin 2008 dhe 2009: 6 kanë pasur vlerë më të lartë, kurse 5 vlerë më të vogël të PDFA-së së vlerës së mesme për 12 komunat. 1 komunë ka pasur vlerë të ngjashme me vlerën e mesme të PDFA-së për 12 komunat. Grafiku në vijim e shpreh këtë në mënyrë figurative:



Grafiku në vijim i ilustron vlerat e indekseve lokale të PDFA-së për të gjitha 12 komunat, paralelisht për vitin 2008 dhe 2009. Qendra e shpreh vlerën 1 të nën-indeksit, që rritet në drejtim të periferisë, deri te vlera maksimale 5.



Edhe prej këtij grafiku shohim që gjysma e komunave kanë vlerë mbi mesataren të PDFA-së. Janë pikërisht komunat që kanë numër më të madh të qytetarëve (ana e djathtë e rrethit), që nënkupton se kanë sistem më të zhvilluar lokal të arsimit. Fatkeqësisht, komunat më të vogla kanë nivel më të ulët të performansave, me përjashtim të një komune rurale, që sipas nivelit të performansave e tejkalon shumicën e komunave urbane. Megjithatë, mbetet përfundimi që nuk ka simetri në aspekt të kapacitetit të menaxhimit me arsimin, që është në favor të komunave më të mëdha.

Përbërja e PDFA-së

PDFA e secilës komunë dhe PDFA në nivel të Maqedonisë është tërësi e treguesve që e pasqyrojnë nivelin që e kanë arritur komunat në zbatimin e politikave arsimore (transferimin e ingjercave dhe obligimeve ligjore), financimin e arsimit, përkushtimin për avancimin e arsimit si shërbim, transparencën dhe llogaridhënien. Për secilën fushë të cekur dhe në pajtim me metodologjinë e këtij vështrimi,


është skenuar gjendja në terren dhe vlerat janë llogaritur me nën-indeksë gjegjëse:

- **NI1:** Nën-indeksi i zbatimit të politikave arsimore nga ana e komunave
- **NI 2:** Nën-indeksi i menaxhmentit financiar të sistemit lokal arsimor
- **NI 3:** Nën-indeksi i shërbimeve komunale në arsim
- **NI 4:** Nën-indeksi i transparencës dhe llogaridhënies në arsim

Secili nën-indeks prej katër të cekurave është llogaritur në fillim për çdo komunë të analizuar ndaras. Pastaj, për çdo nën-indeks është llogaritur vlera mesatare e 12 komunave. PDFA e përgjithshme për Republikën e Maqedonisë është fituar si shumë e vlerave mesatare të çdonjërit prej katër indekseve të cekura.

PDFA në nivel lokal dhe nacional nuk është vlerë e thjeshtë, por shumë e ponderuar e katër nën-indekseve, që do të thotë se ato kanë ndikim të ndryshëm mbi vlerën e PDFA-së. Peshat e ndikimeve të ndryshme të nën-indekseve definohehen sipas anketës së realizuar me nëpunësit përgjegjës shtetërorë dhe kryetarët e komunave-partnere, që kanë qenë pjesë e hulumtimit. Sipas mendimit të tyre, fusha me ndikim më të madh gjatë matjes së performansave në fushën e arsimit duhet të jetë menaxhmenti financiar – ndikimi i të cilit në PDFA "peshon" 32%. Pason nën-indeksi për zbatimin e politikave, me ndikim prej 27%, që vijohet nga nën-indeksi i arsimit si shërbim (25%). Ndikimi më i ulët i është dhënë NI4 – nën-indeksit të transparencës dhe llogaridhënies. Grafiku në vijim e ilustron përbërjen e ndikimit të peshave dhe vlerave të nën-indekseve:


Faktorët e peshës (rëndësisë) së nën-indekseve në IPD Arsimit



Në vijim i shqyrtojmë vlerat e katër nën-indekseve përbërëse të PDFA-së, që tashmë janë elaboruar detajisht. Si që shihet nga tabela, në vitin 2008, komunat kanë marrë notë më të lartë për performanset e shërbimeve komunale në arsim – 3,88. Në vitin 2009, nota më e lartë është shënuar në fushën e implementimit të politikave për decentralizimin e arsimit – 4 prej maksimales 5. Në dy vitet e cekura, komunat kanë marrë notë më të ulët për gjendjen financiare të njësisë së vetëqeverisjes lokale në fushën e arsimit.

	Nën-indeksset	Ndikimi i peshës	RM 2008	RM 2009
1.	Ni 1: Zbatimi i politikave arsimore nga ana e komunave	27%	3,70	4,00
2.	Ni 2: Menaxhmenti financiar i sistemit lokal arsimor	32%	2,56	2,64
3.	Ni 3: Performanset e shërbimeve komunale në arsim	25%	3,88	3,88
4.	Ni 4: Transparenca dhe llogaridhënia në arsim	16%	3,73	3,73
	IPD Arsimit		3,39	3,49

Në vijim jepen vlerat e secilit nën-indeks që e formon IPDA-në për vitin 2008 dhe 2009:



Në vijim do t'i shqyrtojmë dhe analizojmë detajisht të gjithë katër nën-indeksat dhe treguesit që e formojnë atë. Së pari i trajtojmë nën-indeksat, pastaj secilin tregues dhe në fund jepet edhe nota mesatare për të gjitha komunat, sipas kriterëve të dhëna në metodologjinë e përshkruar.

3.2.2 Nën-indeksi i zbatimit të politikave të arsimit nga ana e komunave

Ky nën-indeks e synon pasqyrimin e nivelit në të cilin komunat i zbatojnë politikat arsimore që kanë hyrë në fuqi me decentralizim. Për këtë arsye, nën-indeksi përbëhet nga grupi i treguesve të zgjedhur për pasqyrimin e nivelit në të cilin komuna dhe administrata e saj i kanë zbatuar ingjerenecat e parapara me ligjet për arsimin fillor dhe të mesëm, gjegjësisht: si i përdor komuna këshillat shkollorë, a merr komuna nisma për ndryshimin e rrjetit shkollor, a kanë konstatuar mbikëqyrjet e nivelit qendror ndonjë parregullsi gjatë menaxhimit të sistemit lokal arsimor, a i mban komuna regjistrat arsimorë që parashihen me ligj dhe nëse objektet shkollore janë bartur në pronësinë komunale.

Sipas analogjisë së PDFA-së, edhe ky nën-indeks është llogaritur si shumë e ponderuar e këtyre treguesve. Vlerat e peshës së çdonjërit tregues jepen në grafikun në vijim, ku shihet që rëndësi (peshë) më të madhe ka treguesi 1.3, që ka të bëjë me respektimin e ligjeve dhe politikave të arsimit fillor (26%), kurse rëndësi më të vogël ka treguesi 1.2, që lidhet me nismat e ndërmarra dhe të realizuara për hapjen dhe mbylljen e shkollave (14%).

Faktorët e peshës (rëndësisë) së treguesve në NI 1




Tabela në vijim e jep pasqyrën e të gjithë treguesve të këtij nën-indeksi, ku shfaqet vlera mesatare e secilit nën-indeks për vitin 2008 dhe 2009, si dhe vlera e nën-indeksit të arsimit NI1 për vitin 2008 dhe 2009:

2008		TREGUESI	2009	
Vlera e Nj 1	Vlera mesatare për 12 komunat		Vlera mesatare për 12 komunat	Vlera e Nj 1
3,70	4,50	1.1. Komuna merr pjesë në mënyrë aktive në punën e këshillave shkollorë	4,67	4,00
	2,42	1.2. Komuna ndërmerr dhe realizon nisma për hapjen e shkollave të reja dhe për mbylljen e shkollave ekzistuese	3,08	
	4,42	1.3. Komuna i respekton ligjet dhe politikat e arsimit fillor	5,00	
	3,58	1.4. Komuna mban dokumentacion të rregullt për shkollat e saj, sipas rregullativës ligjore	3,58	
	2,83	1.5. Komuna e ka ndërmarrë pronësinë e objekteve shkollore	2,92	

Vazhdojmë me analizën e secilit tregues ndaras:

Treguesi 1.1. Komuna merr pjesë në mënyrë aktive në punën e këshillave shkollorë

Ky tregues e tregon numrin e këshillave shkollorë (KSH) ku është emëruar përfaqësuesi i komunës, si dhe dinamikën me të cilën informohet Kryetari i komunës për punën e KSH-së.

Vlera mesatare e notës së këtij treguesi, për 12 komunat e hulumtuara në vitin 2008 është 4,50. Për vitin 2009, nota mesatare është 4,67, si një prej treguesve me vlerësim më të lartë në fushën e arsimit. Kjo ndodh për shkak se standardi i këtij treguesi gjendet në dispozitat ligjore, ku përcaktohet që në përbërje të çdo këshilli shkollor duhet të ketë edhe përfaqësues nga njëësia e vetëqeverisjes lokale.

Përfundojmë që në përgjithësi, komunat i respektojnë këto obligime ligjore, meqë vetëm një komunë prej 12 të hulumtuarve nuk ka emëruar përfaqësues në të gjitha këshillat shkollorë të territorit të komunës. Dallimi në notat e komunave të ndryshme shkaktohet nga elementi i dytë i treguesit – dinamika me të cilën informohet Kryetari i komunës dhe administrata për punën e KSH-së. Mesatarisht, raportimet janë periodike dhe vetëm në disa komuna ekziston raportimi i rregullt nga çdo seancë e KSH-së, që është standardi i synuar.

Treguesi 1.2. Komuna ndërmerr dhe realizon nisma për hapjen e shkollave të reja dhe për mbylljen e shkollave ekzistuese

Një prej qëllimeve të bartjes së pronësisë dhe ingjencës për menaxhim me shkollat në nivel lokal, është vendim-marrja e vendimeve për rrijetet shkollore në nivel lokal. Në bazë të analizave të hartuara, që aprovohen nga Ministria e arsimit dhe shkencës,

komuna mund t'i propozojë Këshillit komunal vendim-marrje për hapjen e shkollave të reja ose mbylljen e shkollave ekzistuese ose degëve të arsimit të mesëm. Ky tregues tregon sa komuna në RM e kanë praktikuar këtë ingjercencë.

Nota mesatare për të këtë tregues në 12 komunat e hulumtuara për vitin 2008 ka qenë 2,42, kurse për vitin 2009 – 3,08. Kjo do të thotë që sipas kriterëve të metodologjisë së vëzhgimit, gjendja mesatare është që ka nisma, por ato realizohen shumë ngadalë.

Konkretisht, 5 prej 12 komunave të hulumtuara kanë ngritur nisma për racionalizimin e rrjetit shkollor në vitin 2008, kurse vetëm 3 i kanë realizuar ndryshimet. Në vitin 2009, komunat kanë qenë më aktive dhe 9 prej 12 komunave kanë iniciuar ndryshime. Megjithatë, vetëm 3 komuna i kanë realizuar ndryshimet e kërkuara.

Përfaqësuesit e intervistuar komunalë e kanë cekur ngadalësinë e përgjigjeve të Ministrisë së arsimit dhe shkencës, si pengesë e rëndësishme për realizimin e nismave të këtilla. Për nismat e parashtruara, priten përgjigjet në periudhë kohore 1-3 vite, që mund ta sjellë në pyetje relevancën e elaboratit.

Mospajtimi në Këshillin komunal ka qenë pengesë për realizimin e nismës në një komunë të hulumtuar.

Treguesi 1.3. Komuna i respekton ligjet dhe politikat e arsimit fillor

Ky është tregues i përgjithshëm, që duhet ta tregojë nivelin në të cilin administrata komunale i respekton ligjet dhe në çfarë mase i realizon ingjercencat e fituara në fushën e arsimit. Këtë e masim përmes disa të dhënave – nëse Ministria e arsimit ka shqiptuar masa të caktuara gjatë mbikëqyrjes, si dhe varësisht nga ecuria e komunikimit mes Inspektoratit shtetëror arsimor dhe komunës.

Vlera mesatare e notës së këtij treguesi për 12 komunat e hulumtuara është 4,42 në vitin 2008 dhe 5 në vitin 2009. Masa më e rreptë që është shqiptuar nga Ministria e arsimit dhe shkencës në këtë fushë është marrja e ingjercencave të një komune, në fushën e zgjedhjes së drejtorëve në vitin 2008. Kjo ingjercencë është kthyer vitin e ardhshëm, që ka ndikuar në rritjen e notës.

Kjo do të thotë që komunat i respektojnë ligjet dhe komunikimi me Inspektoratin shtetëror të arsimit është i mirë.

Treguesi 1.4. Komuna mban dokumentacion të rregullt për shkollat e saj, sipas rregullativës ligjore

Ky tregues duhet të tregojë nëse komuna i mban të dhënat për shkollat e saj në regjistrat e paraparë me ligjet e arsimit fillor dhe të mesëm, nëse mban regjistra plotësues, si dhe sistematizimin e tyre.

Nota mesatare e këtij treguesi për 12 komunat e hulumtuara në vitin 2008 dhe 2009 është 3,58. Thënë ndryshe, një komunë aspak nuk mban regjistra për shkollat, 2 komuna mbajnë regjistra në formë që nuk është e sistemuar, 2 komuna e plotësojnë minimumin ligjor (niveli 3) dhe i mbajnë regjistrat e paraparë, 3 komuna mbajnë edhe të dhëna të pasistemuar në plotësim të të dhënave ligjore, kurse 4 komuna mbajnë data-baza dhe regjistra për shkollat dhe të dhënat si plotësim i regjistrave ligjore, që është edhe standardi maksimal i dëshiruar.

Si përfundim, mbi 75% e komunave të analizuara i plotësojnë kërkesat ligjore për mbajtjen e regjistrave, kurse më tepër se gjysma mbajnë edhe regjistra plotësues të të dhënave. Kjo tregon që komunat janë të interesuara për realizim sa më të suksesshëm të ingjercencave të decentralizimit në arsim.

Treguesi 1.5. Komuna e ka ndërmarrë pronësinë e objekteve shkollore

Një prej ndryshimeve të prezantuara me decentralizimin, është edhe bartja e pronësisë së objekteve shkollore në emër të komunës. Vendimi për këtë është miratuar së bashku, për të gjitha shkollat në Republikën e Maqedonisë. Më tej, secila komunë është e obliguar t'i bart shkollat në emër të saj, përmes shërbimit të kadastrës. Për arsye të ndryshme, ky proces nuk mund të realizohet lehtë, kështu që ky tregues duhet të tregojë sa kanë qenë të suksesshme komunat në këtë drejtim.

Vlera mesatare e notës për këtë tregues për 12 komunat e analizuar në vitin 2008 është 2,83 dhe 2,92 në vitin 2009. Në vitin 2008, ka pasur 5 komuna që nuk kanë pronësi mbi asnjë objekt shkollore në territorin e tyre. Ky numër është ulur në 4 komuna në vitin 2009. Në vitin 2008 ka pasur 4 komuna që e kanë marrë pronësinë mbi të gjitha objektet shkollore, njëjtë si edhe në vitin 2009.

Mesatarisht, komunat kanë marrë pronësinë për mbi 30-60% të objekteve shkollore. Ekzistojnë disa shkaqe të arsyeshme për gjendjen e këtillë, që kryesisht i përshkruhet marrëdhëniet e pazgjidhura pronësore-juridike dhe pronësore të objekteve, si dhe evidencës së paqartë të kadastrës. Megjithatë, mbetet përshtypja që komunat janë përkushtuar maksimalisht për marrjen e pronësisë formale-juridike mbi objektet shkollore.

3.2.3 Nën-indeksi i menaxhimit financiar me sistemin lokal arsimor

Realizimi i të gjitha injerencave, përfshirë edhe arsimin, është i mundur vetëm nëse mbështetet me mjete gjegjëse financiare. Me procesin e decentralizimit, niveli qendror i transferon NJML-ve shumë të caktuar të mjeteve, në formën e dotacionit. Por, ekziston edhe mundësia e ndarjes së mjeteve financiare nga burimet vetanake të komunës, me qëllim të përmirësimit të performansave në arsim.

Përveç shumës të të hollave në dispozicion, rëndësi shumë të madhe ka edhe mënyra në të cilën menaxhohen këto mjete, si dhe mënyra e kontrollimit të shpenzimeve në arsim. Ky nën-indeks e synon pasqyrimin e pozitës së marrë nga komunat, ndaj financimit të shkollave të tyre.

Për këtë qëllim, në kuadër të këtij nën-indeksi kemi bërë përzjerje të 6 treguesve, që duhet të na tregojnë: në çfarë raporti janë mjetet totale të shpenzuara për arsim dhe dotacionet e pranuar nga niveli qendror; sa është pjesëmarrja e mjeteve lokale të komunës në totalin e shpenzimeve për arsim; sa dotacione kapitale për arsimin janë marrë nga niveli qendror në emër dhe dispozicion të komunës; a kanë financuar komunat angazhim të kuadrit plotësues në shkolla dhe nëse po, sa efektiv ka qenë menaxhimi me mjetet financiare në dispozicion për arsimin. Sipas vlerësimit të pjesëmarrësve të hulumtimit, ndikimi relativ i këtij nën-indeksi në indeksin total është 32%.

Në vijim jepen vlerat e peshës së çdo treguesi që e formojnë këtë nën-indeks, ku shihet që peshë (rëndësi) më të madhe ka treguesi 2.6, që ka të bëjë me menaxhmentin efektiv financiar në kuadër të sistemit lokal arsimor (30%), kurse nivel më të ulët kanë treguesit 2.1 dhe 2.4 (5%) që lidhen me mjetet e shpenzuara për arsim, në raport me mjetet për arsim që janë pranuar përmes bllok-dotacioneve, si dhe shumës së dotacioneve kapitale nga niveli qendror për fushën e arsimit – në emër dhe dispozicion të komunës.

Faktorët e peshës (rëndësisë) së treguesve në NI 2




Tabela në vijim e jep pasqyrën e të gjithë treguesve të këtij nën-indeksi, vlerën mesatare të çdo treguesi për vitin 2008 dhe 2009, si dhe vlerën e nën-indeksit të arsimit NI1 në vitin 2008 dhe 2009.

Nën-indeksi i menaxhmetit financiar të sistemit lokal arsimor

2008		
Vlera e NI 2	Vlera mesatare për 12 komunat	TREGUESI
2,56	3,33	2.1. Raporti i gjithsej mjeteve të shpenzuara për arsim dhe mjeteve të pranura përmes dotacionit nga niveli qendror
	2,25	2.2 Pjesëmarrja e mjeteve vetanake të komunës në total shpenzimet për arsim
	2,08	2.3. Të datat kapitale të dedikuara për arsim
	1,42	2.4. Shuma e dotacioneve kapitale për arsim, të pranura nga niveli qendror, në emër dhe dispozicion të komunës
	1,75	2.5. Kuadri plotësues i mësimdhënësve, që financohet nga komuna
	3,67	2.6. Menaxhmenti efektiv financiar me sistemin lokal arsimor

2009		
TREGUESI	Vlera mesatare për 12 komunat	Vlera e NI 2
2.1. Raporti i gjithsej mjeteve të shpenzuara për arsim dhe mjeteve të pranuar përmes dotacionit nga niveli qendror	3,17	2,64
2.2 Pjesëmarrja e mjeteve vetanake të komunës në total shpenzimet për arsim	2,33	
2.3. Të dalat kapitale të dedikuara për arsim	2,33	
2.4. Shuma e dotacioneve kapitale për arsim, të pranuar nga niveli qendror, në emër dhe dispozicion të komunës	1,33	
2.5. Kuadri plotësues i mësimdhënësve, që financohet nga komuna	1,92	
2.6. Menaxhmenti efektiv financiar me sistemin lokal arsimor	3,67	

Nga tabela shohim që vlera e nën-indeksit të gjendjes financiare të arsimit është rritur pak - prej 2,56 (2008) në 2,64 (2009). Komunat tregojnë rezultate të mira në menaxhimin me mjetet në dispozicion – për treguesin 2.6 kanë treguar rezultate më të mira. Por, gjendja nuk është aq e mirë me ndarjen e mjeteve vetanake për arsimin, si dhe

investimet kapitale në arsim. Më së dobëti funksionojnë dotacionet shtetërore kapitale për arsim, që aplikohen vetëm në disa komuna. Në vijim i analizojmë në detaje gjashtë treguesit e këtij nën-indeksi:

Treguesi 2.1. Raporti i gjithsej mjeteve të shpenzuara për arsim dhe mjeteve të pranuar përmes dotacionit nga niveli qendror

Ky tregues është i përgjithshëm dhe jep pasqyrë gjenerale për mjetet që i ka shpenzuar komuna në arsim, në raport me mjetet e pranuar nga pushteti qendror përmes dotacionit. Treguesi fitohet si raport i total mjeteve të realizuara për arsimin fillor dhe të mesëm në çdo komunë, ndaj total mjeteve të fituara nga niveli qendror me bllok-dotacione.

Nota mesatare e këtij treguesi, në 12 komunat e hulumtuara në vitin 2008 është 3,33, e ulur në 3,17 në vitin 2009. Shpenzimi mesatar gjatë vitit 2008 ka qenë 100,14%, që do të thotë se komunat e analizuar kanë shpenzuar vetëm 0,14% më tepër se dotacionet kapitale (të dedikuara) për arsim. Në vitin 2009, kjo mesatare ka qenë 98,5%, që do të thotë se komunat nuk i kanë shpenzuar të gjitha mjetet e pranuar nga pushteti qendror si dotacion.

Nëse i shohim gjendjet e komunave ndaras, do të shohim që ky raport, në vitin 2008 ka lëvizur mes 89,1% dhe 116,6%, që do të thotë se ka pasur komuna që kanë shpenzuar mjete plotësuese për arsim, por edhe komuna që nuk i kanë shpenzuar të gjitha mjetet e dotacioneve. Analiza ka treguar që 4 komuna kanë investuar mjete plotësuese ose kanë pranuar donacione të jashtme për arsim. Shumica e komunave (7) shpenzojnë mjete në vlerë prej 90% deri 100% të mjeteve të pranuar nga niveli qendror dhe vetëm një komunë ka shpenzuar më pak se 90% e dotacioneve të pranuar. Në vitin 2009, ky raport ka lëvizur prej 77,1% (në komunën me vlerësim më të ulët) deri në 121,5% (si raporti më i lartë i regjistruar). Edhe këtu, 4 komuna kanë investuar mjete plotësuese, 5 komuna

kanë shpenzuar prej 90% deri në 100% dhe 3 komuna kanë shpenzuar më pak se 90% e mjeteve të pranuara.

Përfundojmë që mesatarisht, komunat shpenzojnë për arsim shumë të njëjtë me shumën e mjeteve të fituara nga pushteti qendror, përmes dotacioneve.

Treguesi 2.2. Pjesëmarrja e mjeteve vetanake të komunës në total shpenzimet për arsim

Edhe ky tregues trajton një problematikë të ngjashme, por nga aspekti tjetër: na tregon nivelin e pjesëmarrjes së komunës me mjete financiare nga burimet e saj, në financimin e ingjierencave të arsimit. Treguesi fitohet kur mbliidhen të gjitha mjetet vetanake të investuara nga komuna në arsim (mirëmbajtja e vazhdueshme, investimet, inventari i vogël) për nxënës dhe pjesëtohen me mjetet e realizuara në arsim për nxënës, sipas llogarisë përfundimtare të komunës.

Mesatarisht, në të gjitha 12 komunat, në vitin 2008 komunat kanë marrë pjesë në totalin e shpenzimeve të arsimit me 9%. Në vitin 2009, kjo përqindje është ulur në 7,8%.

Sipas kriterëve të vlerësimit, nota mesatare për 12 komunat e hulumtuara në vitin 2008 është 2,25, kurse në vitin 2009 është 2,33. Analizuar ndaras, në vitin 2008 ka 2 komuna që nuk kanë investuar asnjë denar të mjeteve vetanake. Numri më i madh i komunave (7) kanë investuar mjete vetanake në vlerë prej 0,1 deri 3%. Niveli më i lartë i shënuar ka qenë 6,7%, përveç një komune, që gjendet në fazën e parë të decentralizimit (me 92%). Në vitin 2009, ka pasur 1 komunë pa investime vetanake dhe 10 komuna kanë qenë prej nivelit më të ulët të investimit të mjeteve vetanake (0,1 deri 3%). Përqindja më e lartë të komunat e fazës së dytë ka qenë 3,43%.

Përfundojmë që shumica e komunave investojnë mjete vetanake në arsim, që është dukuri pozitive dhe në fakt, është një prej qëllimeve të arsimit të decentralizuar. Megjithatë, kjo shumë mbetet shumë e vogël. Për këtë arsye, nota mesatare e këtij treguesi është më e ulët se 3 në dy vitet e hulumtuara.

Treguesi 2.3. Të dalat kapitale të dedikuara për arsim

Prej këtij treguesi shohim sa të dala kapitale janë dedikuar për arsim, në raport me totalin e të dalave kapitale të komunës. Kjo llogaritet kur totali i të dalave kapitale për arsimin fillor dhe të mesëm (vetanake ose përmes dotacioneve kapitale të MASH-it) pjesëtohen me totalin e shpenzimeve kapitale të komunës.

Vlera mesatare e notës për këtë indikator është 2,08 në vitin 2008 dhe 2,33 në vitin 2009, për të gjitha 12 komunat e hulumtuara. Sipas të dhënave nominale, në vitin 2008, pjesëmarrja mesatare e të dalave kapitale për arsim në totalin e të dalave kapitale të komunës ka qenë vetëm 2,1%, që është rritur në 4,2% në vitin 2009. Analizuar ndaras, në vitin 2008 ka pasur 5 komuna (41,6%) që aspak nuk kanë pasur ndikime kapitale në arsim, kurse raporti më i lartë i regjistruar është 10,87% e totalit të dalave kapitale. Në vitin 2009, numri i komunave që nuk kanë pasur ndikime kapitale në arsim është ulur në 3, kurse niveli më i lartë i regjistruar ka aritur 21,9% e totalit të dalave kapitale.

Në përgjithësi, mund të përfundohet që të dalat kapitale në arsim janë shumë të vogla, krahasuar me totalin e të dalave kapitale të komunës. Por, shënohet tendencë pozitive prej vitit 2008 në vitin 2009 dhe është mirë që kjo të vazhdojë edhe në ardhmëri.

Treguesi 2.4. Shuma e dotacioneve kapitale për arsim, të pranuar nga niveli qendror, në emër dhe dispozicion të komunës

Ky tregues duhet të tregojë nëse pushteti qendror ka bartur mjete për investime kapitale në shkolla, si dhe shumën e mjeteve të bartura –përmes buxhetit komunal dhe jo direkt prej nivelit qendror në shkolla. Kjo mënyrë e financimit të investimeve kapitale është shumë e rëndësishme për autonominë financiare të komunës, si dhe për orientimin e drejtë dhe ekonom të investimeve në arsim.

Vlera mesatare e notës së këtij treguesi, për 12 komunat e analizuar në vitin 2008 është 1,42. Për vitin 2009, vlera është 1,33 dhe ky është treguesi me notë më të ulët në fushën e arsimit. Në vitin 2008, vetëm 3 komuna kanë pranuar mjete për investime kapitale në arsim – me shuma të ndryshme (prej 42, 87 deri në 637 denarë për nxënës). Në vitin 2009 sërish kanë qenë vetëm 3 komuna që kanë pranuar dotacione të këtylla nga niveli qendror, në shumë prej 11, 55 deri në 467 denarë për nxënës.

Në përgjithësi, gjendja aktuale tregon që shumica e komunave nuk ka marrë mbështetje nga pushteti qendror përmes buxheteve komunale për investimet kapitale në arsim, por kjo është realizuar drejtpërdrejtë – nga niveli qendror tek shkollat. Kjo tregon që pushteti qendror nuk e respekton Ligjin për financimin e njësisve të vetëqeverisjes lokale dhe nuk i transferon dotacionet kapitale në komuna, por drejtpërdrejtë në shkolla.

Treguesi 2.5. Kuadri plotësues i mësimdhënësve, që financohet nga komuna

INdonëse nuk janë të obliguara me ligj, disa komuna angazhojnë kuadër plotësues të mësimdhënësve, që financohet me buxhetin e komunës. Kjo ndodh shpesh herë, me qëllim të rritjes së cilësisë së arsimit dhe më së shpeshti ndodh për ta parandaluar ndërprerjen e procesit mësimor, kur mungojnë mësimdhënësit e rregullt,

etj. Sidoqoftë, me këtë praktikë është krijuar një standard i ri, që përfshihet në këtë analizë për shkak të rëndësisë. Ky tregues na tregon numrin e personave të kuadrit mësimdhënës dhe personelit ndihmës, që financohen si shtojcë nga komuna. Për krahasimin e të dhënave në nivel republikan, nuk e kemi marrë parasysh shumën e mjeteve të dedikuara, por numrin absolut të personave të angazhuar si plotësim.

Prej grupit tonë të 12 komunave, në vitin 2008, 4 komuna kanë financuar forcë plotësuese të punës në arsim – njëjtë si edhe në vitin 2009. Për 12 komunat e analizuar, nota mesatare e këtij treguesi është 1,75 në vitin 2008 dhe 1,92 për vitin 2009.

Praktikisht, kjo do të thotë që angazhimi i kuadrit plotësues mësimor që financohet nga mjetet vetanake të komunës, nuk praktikohet shpesh nga komunat. Megjithatë, ekziston si dukuri dhe ka tendencë pozitive.

Treguesi 2.6. Menaxhmenti efektiv financiar me sistemin lokal arsimor

Ky tregues e pasqyron nivelin e aftësisë së administratës komunale për menaxhim efektiv me mjetet e dedikuara për arsim: në çfarë baze dhe si shpërndahen dhe transferohen mjetet, a mbahet llogari për shpenzimet, etj.

Kjo matet si shumë kumulative e disa ndryshoreve: ekzistimi i vendimit të Këshillit komunal për matjen dhe kriteret e shpërndarjes së mjeteve mes shkollave të komunës; procedurat e krijuara lokale për rregullimin e punës buxhetore dhe planifikimit të shkollave; analizat e gjendjes financiare dhe nevojave të shkollave që janë bërë në bazë të treguesve organizativë, financiarë dhe treguesve tjerë; elaboratet e përgatitura për racionalizimin e shpenzimeve të shkollave, si dhe transferet e mjeteve financiare në kohën e duhur.

Nota mesatare e këtij treguesi, për 12 komunat e hulumtuara është 3,67. Kjo notë tregon gjendje të mirë, por vërehen disa gjëra:

- Rrallë herë respektohet obligimi ligjor për vendim të Këshillit komunal për mjetet matëse dhe kriteret e shpërndarjes së mjeteve të bllok-dotacioneve mes shkollave në territorin komunal. Miratimi i vendimeve të këtilla nënkupton që ekziston parashikueshmëri, objektivitet dhe transparencë gjatë shpërndarjes së mjeteve dhe kjo duhet të ndodh në nivelin lokal.
- Analiza e gjendjes financiare dhe nevojave të shkollave duhet të bëhet sa më shpesh – në mënyrë të sistematizuar dhe konzistente. E njëjta vlen edhe për hartimin e elaborateve dhe planeve për racionalizimin e shpenzimeve të shkollave.

3.2.4 Nën-indeksi i shërbimeve komunale në arsim

Shpesh harrojmë që edhe arsimit është shërbim për qytetarët, për të cilin duhet të ekzistojnë standarde të "realizimit" dhe cilësisë. Ky shërbim sigurohet me përpjekje të përbashkët të nivelit qendror dhe atij lokal gjatë procesit të decentralizimit. Nën-indeksi për performanset e shërbimeve të arsimit fokusohet në pjesën e përgjegjësisë, që i takojnë komunave dhe i përfshin këto 4 tregues: pajisjen e shkollave sipas normativave dhe standardeve të përcaktuara për hapësirën dhe pajisjen; efektivitetin e sigurimit të transportit falas për nxënësit dhe ngrohjes së shkollave; kapacitetin administrativ të angazhuar për menaxhim me arsimin dhe qasjen strategjike të menaxhimit me sistemin lokal arsimor dhe të shërbimeve.

Ky nën-indeks ka ndikim relativ në indeksin total prej 25%. Është hulumtuar në vitin 2008 dhe 2009, me pyetje cilësore në të cilat janë

përgjigjur nëpunësit shtetërorë, të intervistuar në fazën e mbledhjes të të dhënave. Në nivel republikan, nota mesatare është 3,88.

Grafiku në vijim i jep vlerat e peshës së çdo treguesi që e formojnë këtë nën-indeks, ku shihet që peshë më të madhe (35%) ka treguesi 3.1, që ka të bëjë me pajisjen e shkollave drejt harmonizimit me normativat dhe standardet e hapësirës dhe pajisjes:

Faktorët e peshës (rëndësisë) së treguesve në NI 3




Tabela në vijim i prezanton të gjithë treguesit e këtij nën-indeksi, vlerën mesatare të secilit për vitin 2008 dhe 2009, si dhe vlerën e nën-indeksit të arsimit për NI1 në vitin 2008 dhe 2009:

TREGUESI	2008/2009	
	Vlera mesatare për 12 komunat	Vlera e N3
3.1. Komunat pajisen drejt harmonizimit me normativat dhe standardet për hapësirë dhe pajisje	3,92	3,88
3.2. Efektiviteti në sigurimin e transportit falas për nxënësit dhe ngrohjen e shkollave	4,58	
3.3. Kapaciteti organizativ për menaxhim me sistemin dhe shërbimet lokale arsimore	4,17	
3.4. Qasja strategjike në menaxhimin me sistemin dhe shërbimet lokale arsimore	2,75	

Prej tabelës shihet që komunat e organizojnë me sukses transportin e nxënësve dhe furnizimin e ngrohjes për shkollat. Por, komunat nuk kanë arritur të ndërtojnë qasje të fuqishme strategjike ndaj arsimit. Në vijim i analizojmë detajisht katër treguesit që e përbëjnë këtë nën-indeks:

Treguesi 3.1. Komunat pajisen drejt harmonizimit me normativat dhe standardet për hapësirë dhe pajisje

Ministria e arsimit dhe shkencës ka sjellë normativa dhe standarde për hapësirat dhe pajisjen e shkollave, që janë standarde minimale që duhet të ekzistojnë në çdo shkollë. Në momentin kur shkollat janë transferuar në nivel lokal, ka ekzistuar konstatimi i përgjithshëm që pajisja e shkollave është nën standardet e caktuara. Pushteti qendror nuk ka përgatitur dotacione të dedikuara ose ndonjë mekanizëm tjetër për t'i dorëzuar shkollat në gjendje solide. Në vend të kësaj, i ka dhënë obligim të qartë pushteteve lokale të kujdesen për punën

e shkollave, në bazë të normativave dhe standardeve të caktuara. Me këtë tregues ne vlerësojmë nëse administrata komunale i njej normativat, nëse e kanë skenuar gjendjen e shkollave dhe nëse kanë investuar mjete plotësuese në inventarin dhe pajisjen shkollore.

Shikuar sipas komunave, vetëm 2 komuna nuk kanë dëgjuar për normativat dhe standardet, nuk kanë bërë analiza të gjendjes së shkollave dhe nuk kanë ndarë mjete për këtë qëllim. Nga ana tjetër, 7 prej 12 komunave kanë marrë nota më të larta, që do të thotë se i njohin normativat, e incizojnë gjendjen dhe investojnë mjete. Por, pa dallim nga kjo pasqyrë e anketës, është e dobishme të bëhen hulumtime tjera në këtë temë. Vlera mesatare e notës së këtij treguesi për 12 komunat e hulumtuara është 3,92.

Përfundim gjeneral është që komunat i njohin normativat dhe standardet, kanë realizuar disa incizime të gjendjes dhe disa prej tyre kanë investuar mjete për përmirësimin e gjendjes, sipas planeve dhe programeve të definuara paraprakisht.

Treguesi 3.2. Efektiviteti në sigurimin e transportit falas për nxënësit dhe ngrohjen e shkollave

Ky tregues duhet të na tregojë sa është efektiv sigurimi i transportit dhe ngrohjes në shkollat e komunës. Matja bazohet në kombinimin e ndryshoreve: mënyra e realizimit të furnizimeve publike, rregullshmëria e sigurimit të ngrohjes dhe transportit të nxënësve, arsyet për vonesat eventuale dhe (mos)ndërprerja e mësimin për shkak të mungesës së transportit ose ngrohjes.

Vlera mesatare e notës së këtij treguesi, për 12 komunat e analizuar është 4,58. Kjo është pothuajse gjendje ideale dhe shenjë që komunat e organizojnë me sukses transportin falas për nxënësit dhe ngrohjen e shkollave, pa vonesa të konsiderueshme në sigurimin e shërbimit dhe pa ndërprerje të mësimin.

Treguesi 3.3. Kapaciteti organizativ për menaxhim me sistemin dhe shërbimet lokale arsimore

Nuk mund të ketë rezultate pa angazhim të burimeve adekuata njerëzore që do ta organizojnë dhe menaxhojnë realizimin e shërbimit – veçanërisht jo në shërbime masive, si që është arsimi. Për këtë arsye është futur ky tregues, që duhet ta zbulojë potencialin njerëzor të administratës komunale, të angazhuar për fushën e arsimit (nëse ka ndonjë person që punon në fushën e arsimit, nëse kjo bëhet ekskluzivisht ose pjesërisht, nëse ekziston inspektor komunal për arsim dhe si komunikon komuna me shkollat e saj).

Pesë prej komunave të hulumtuara (41,7%) kanë punësuar një ose më tepër persona që punojnë ekskluzivisht në arsim, kanë inspektor për arsim dhe praktikojnë 3-5 mënyra për komunikim me shkollat. Vetëm 2 komuna (16,7%) nuk kanë asnjë person me detyra në arsim (madje edhe vetëm një pjesë të orarit të punës), nuk kanë inspektor lokal për arsim dhe shfrytëzojnë më pak se dy mënyra për të komunikuar me shkollat. Vlera mesatare e notës së këtij treguesi është 4,17 për 12 komunat e hulumtuara.

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë që mesatarisht, në komuna punon personi me vetëm një pjesë të orarit të punës në fushën e arsimit. Më së shpeshti ka inspektor për arsim dhe aplikohen deri në dy mënyra dhe forma për komunikim me shkollat.

Treguesi 3.4. Qasja strategjike në menaxhimin me sistemin dhe shërbimet lokale arsimore

Ky tregues është shumë i rëndësishëm, meqë na tregon sa është i rëndësishëm arsimi për komunën. Treguesi matet me kombinimin e disa ndryshoreve: nëse ekziston strategjia për arsim dhe në çfarë forme, nëse ka projekte të buxhetuara nga kjo strategji dhe nëse rezultatet e vetë-vlerësimit të shkollave përfshihen në procesin e

planifikimit strategjik të komunës.

Për 12 komunat e hulumtuara, vlera mesatare e notës së këtij treguesi është 2,75. Kjo notë është relativisht e ulët, meqë nënkupton që mesatarisht, komunat nuk kanë strategji të posaçme për arsim, por arsimi është në kuadër të Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal ose strategjive të ngjashme. Më tej, niveli mesatar tregon që rallë herë buxhetohen projekte strategjike arsimore dhe nuk aplikohet procesi i planifikimit strategjik.

Brengos fakti që madje 5 komuna janë në nivelin themelor me notën 1, që do të thotë se nuk kanë asnjë strategji për arsim, nuk buxhetojnë projekte strategjike për arsim dhe nuk i marrin parasysh rezultatet e vetë-vlerësimit të shkollave.

Në përgjithësi, mund të thuhet që shkollat nuk kanë strategji të posaçme për zhvillimin e arsimit, buxhetet komunale rallë herë financojnë projekte strategjike arsimore dhe rezultatet e vetë-vlerësimit shumë pak përdoren në procesin e planifikimit strategjik.

3.2.5 Nën-indeksi i transparencës dhe llogaridhënies në arsim

Transparenca dhe llogaridhënia në komunë nuk duhet të harrohen për asnjë ingjerençë. Së këndejmi, vëzhgimi e përcjell transparencën dhe llogaridhënien edhe në fushën e arsimit. Nën-indeksi përbëhet prej dy treguesve, që në vete ngërthejnë shumë elemente: transparencën dhe puna publike e komunës në fushën e arsimit, si dhe llogaridhënia e punës dhe qasja ndaj informatave me karakter publik. Treguesit vlerësohen në bazë të përgjigjeve cilësore, të mbledhura me pyetësorët dhe intervistat e realizuara.

Faktori i peshës së këtij nën-indeksi është 16/100, që do të thotë se nën-indeksi merr pjesë me 16% në vlerën totale të IPDA-së. Sipas mendimit të nëpunësve përgjegjës shtetërorë dhe Kryetarëve të komunave-partnere, ky nën-indeksi është faktori me rëndësi më

të vogël për decentralizimin fiskal. Mesatarja republikane është 3,73 dhe hulumtimi e ka përfshirë vitin 2008 dhe 2009.

Në vijim jepen vlerat e rëndësisë së çdo treguesi të nën-indeksit, ku shihet që dy treguesit kanë rëndësi (peshë) përafërsisht të njëjtë:

Faktorët e peshës (rëndësisë) së treguesve në NI 4




Tabela në vijim e jep pasqyrën e treguesve të nën-indeksit, vlerën mesatare të secilit tregues për vitin 2008 dhe 2009, si dhe vlerën e nën-indeksit të arsimit NI1 për vitin 2008 dhe 2009.

TREGUESI	2008/2009	
	Vlera mesatare për 12 komunat	Vlera e NI 4
4.1. Transparenca dhe puna publike e komunës në fushën e arsimit	3,92	3,73
4.2. Llogaridhënia në punë dhe qasja ndaj informatave me karakter publik	3,58	

Treguesi 4.1 Transparenca dhe puna publike e komunës në fushën e arsimit

Vlera e këtij treguesi na tregon nivelin e transparencës dhe punës publike të komunës në fushën e arsimit. Përfshihen disa ndryshore: mënyra e informimit të qytetarëve për çështjet e lidhura me arsimin; organizimi i takimeve mes përfaqësuesve të këshillave shkollorë dhe udhëheqësisë/administratës komunale; takimet mes asociacioneve rinore të qytetarëve dhe udhëheqësisë komunale për temat e lidhura me arsimin.

Vlera mesatare e notës së këtij treguesi është 3,92 për 12 komunat e hulumtuara.

Gjendja mesatare: aplikohen katër mënyra për informimin e qytetarëve për arsim; disa komuna organizojnë takime mes udhëheqësisë komunale dhe përfaqësuesve të këshillave shkollore, por më shpesh organizohen takime me asociacionet

e qytetarëve, për temat e lidhura me arsimin dhe kryesisht në nivel vjetor.

Treguesi 4.2. Llogaridhënia në punë dhe qasja ndaj informatave me karakter publik

Llogaridhënia dallon pak nga transparencja, për shkak se lidhet me mënyrat në të cilat komuna jep llogari para qytetarëve për burimet financiare dhe burimet tjera të angazhuara në arsim. Gjatë vlerësimit të vlerës së këtij treguesi, merret parasysh gjërat në vijim: publikimi i temave arsimore në raportet ose materialet informative për qytetarët; publikimi i planeve financiare dhe llogarive përfundimtare të shkollave në gazetën zyrtare komunale; nëse informatat publike të fushës së arsimit gjenden në ueb-faqen e komunës dhe nëse raportet e vetë-vlerësimit të shkollave publikohen në ueb-faqen e komunës.

Vlera mesatare e notës së këtij treguesi, për 12 komunat e hulumtuara, është 3,58 dhe mund të përshkruhet kështu: arsimi përfaqësohet pjesërisht në raportet dhe materialet informative; raportet financiare të shkollave publikohen në gazetën zyrtare; informatat publike nga fusha e arsimit nuk publikohen në ueb-faqen e komunës dhe raportet e vetë-vlerësimit nuk publikohen në ueb-faqen e komunës (ndonëse kjo kërkohet me ligj).

Të gjitha komunat sigurojnë forma dhe mënyra për informimin e qytetarëve me të dhënat e lidhura me arsimin, të cilat i publikojnë. 11 prej 12 komunave i publikojnë raportet financiare të shkollave në gazetën zyrtare të komunës.

Raportet e vetë-vlerësimit të shkollave nuk publikohen në ueb-faqet e asnjë komune, që nuk është në pajtim me dispozitat ligjore.

3.3 Urbanizmi

3.3.1 Indeksi i performansave të decentralizimit në fushën e urbanizmit dhe planifikimit urban (IPDU)

Realizimi i decentralizimit në fushën e urbanizmit dhe planifikimit urban e masim përmes IPDU-së – indeksi i performansave të decentralizimit në fushën e urbanizmit dhe planifikimit urban. IPDU është tërësi e treguesve që e pasqyrojnë nivelin e arritur nga komunat në fushën e zbatimit të politikave të urbanizmit dhe planifikimit urban. Në vitin 2008, ky indeks ka qenë 3,12 për 12 komunat e analizuar dhe ka rënë në 3,05 në vitin 2008. Kjo do të thotë që mesatarja e të gjitha komunave shënon rënie të butë (2,25%).

Indeksi IPDU përbëhet nga 4 nën-indekse dhe madhësia e tij varet nga disa ndikime. Nën-indeksi i parë (NI 1) ka të bëjë me zbatimin e politikave të decentralizimit, në fushën e urbanizmit dhe planifikimit urban. Në esencë, ky nën-indeks e tregon perceptcionin e komunave për lirinë e tyre në zbatimin e ingerencave. Nën-indeksi i dytë (NI 2) e mat gjendjen financiare të komunave në fushën e urbanizmit dhe planifikimit urban dhe i pasqyron kapacitetet fiskale të komunave për hartimin dhe realizimin e planeve urbane. Nën-indeksi i tretë (NI 3) i mat performanset e shërbimeve komunale në pjesën e urbanizmit dhe planifikimit urban dhe ka të bëjë me efikasitetin dhe efektivitetin e komunave në ofrimin e shërbimeve të ndryshme të fushave të ingerencës. Nën-indeksi i katërt (NI 4) e pasqyron transparencën dhe llogaridhënien e NJVL-ve në fushën e urbanizmit dhe planifikimit urban, në bazë të hapave të ndërmarrë ligjorë nga komunat, me qëllim të informimit lidhur me zbatimin e ingerencave, si dhe në bazë të aktiviteteve tjera individuale që i realizojnë komunat për sigurim të transparencës dhe llogaridhënies më të madhe të komunave për ingerencat e deleguara.


Në tabelën në vijim jepen nën-indeksat që e formojnë IDF-në me faktorët e vlerave, për vitin 2008 dhe 2009:

	Nën-indekset	Faktori i rëndësisë	RM 2008	RM 2009
1.	NI 1 – Implementimi i politikave të decentralizimit në fushën e urbanizmit	28%	2,59	2,62
2.	NI 2 – Gjendja financiare e NJVL-ve në fushën e urbanizmit	31%	3,44	3,13
3.	NI 3 – Performanset e shërbimeve të NJVL-ve në fushën e urbanizmit	24%	3,13	3,18
4.	NI 4 – Transparenca dhe llogaridhënia në fushën e urbanizmit	17%	3,42	3,42
	IPDU		3,12	3,05

Si që shihet nga tabela, rëndësi më të madhe në implementimin e ingjercave të urbanizmit dhe planifikimit urban ka nën-indeksi NI 2, që e tregon gjendjen financiare të NJVL-së në fushën e urbanizmit. Rëndësia më e vogël i për decentralizimin e ingjercës i është dhënë nën-indeksit NI 4 – transparenca dhe llogaridhënia në fushën e urbanizmit dhe planifikimit urban.


Grafiku në vijim i jep faktorët e rëndësisë për çdo nën-indeks:

Faktorët e peshës (rëndësisë) së nën-indekseve




Vlera e indeksit për performanset e decentralizimit në fushën e urbanizmit dhe planifikimit urban (IPDU), si dhe vlerat e nën-indekseve për vitin 2008 dhe 2009, në nivel në RM-së, jepen në vijim:


Analiza krahasuese e IPDU për vitin 2008 dhe 2009



Prej 12 komunave të vëzhguara në vitin 2008, 6 kanë pasur vlerë më të lartë dhe 6 vlerë të ngjashme me vlerën mesatare të IPDU-së për 12 komunat. Në vitin 2009, 6 kanë pasur vlerë më të lartë, 5 kanë pasur vlerë të ngjashme me vlerën e mesme dhe një komunë ka pasur IPDU më të vogël se vlera mesatare e IPDU-së për 12 komunat. Grafiku në vijim e ilustron gjendjen:



Grafiku në vijim i ilustron vlerat e indeksit IPDU për secilën prej 12 komunave të vëzhguara, paralelisht për vitin 2008 dhe 2009. Qendra e tregon vlerën 1 të nën-indeksit, që rritet drejt periferisë me vlerën maksimale 5.




Në vijim jepet përshkrimi i detajuar i secilit nën-indeks të IPDU-së dhe treguesve që e formojnë nën-indeksin konkret. Së pari jepet përshkrimi i secilit tregues dhe pastaj jepet nota, në bazë të kriterëve të përshkruara në metodologjinë e cekur.

3.3.2 Nën-indeksi i zbatimit të politikave të decentralizimit në fushën e urbanizimit

Ky nën-indeks formohet nga treguesit përmes të cilëve jepet vlerësimi për masën e implementimit të politikave nacionale dhe/ose kontributit të tyre për decentralizim të suksesshëm. Faktori i rëndësisë së këtij nën-indeksi është 28/100, që do të thotë se ky nën-indeks merr pjesë me 28% në vlerën totale të IPDU-së.

Faktorët e rëndësisë së çdo treguesi të këtij nën-indeksi jepen në grafikon në vijim:

Faktorët e peshës (rëndësisë) së treguesve në NI 1



35% - T 4.1
68% - T 4.2

Tabela në vijim i jep vlerat e nën-indeksit dhe vlerat mesatare të treguesve që e formojnë atë, së bashku me notat gjegjëse mesatare të treguesve të të gjitha komunave për vitin 2008 dhe 2009. Më poshtë jepet edhe përshkrimi i detajuar i secilit tregues. Vlera e këtij nën-indeksi është rritur prej 2,59 në vitin 2008 në 2,62 në vitin 2009.

2008			TREGUESI
NI 1	Vlera mesatare e treguesit	Nota mesatare e treguesit	
2,59	0,72	3,83	1.1 Bashkëpunimi mes komunës dhe pushtetit qendror
	1,62	2,00	1.2 Liria në realizimin e ingerencës

TREGUESI	2009		NI 1
	Nota mesatare e treguesit	Vlera mesatare e treguesit	
1.1 Bashkëpunimi mes komunës dhe pushtetit qendror	3,92	0,69	2,62
1.2 Liria në realizimin e ingerencës	2,00	1,62	

Ky indeks rritet kryesisht për shkak të numrit të rritur të pëlqimeve për planet urbane nga ana e ministrive gjegjëse gjatë vitit 2009.

Treguesi 1.1: Bashkëpunimi mes komunës dhe pushtetit qendror në fushën e urbanizimit dhe planifikimit urban.

Ky tregues e tregon masën në të cilën pushteti qendror i përcjell aktivitetet e NJML-së në fushën e miratimit të dokumentacionit urbanistik. Duke marrë parasysh faktin që NJML-të obligohen me ligj të kërkojnë dhe të marrin pëlqime për dokumentacionin urbanistik nga ministrinë dhe agjencitë gjegjëse (si dhe për disa aktivitete tjera që kanë të bëjnë me planifikimin urban), ky tregues e jep raportin mes pëlqimeve të kërkuara nga NJML-ja dhe pëlqimet e aprovuara nga pushteti qendror. Sa më i madh që është ky tregues, aq më i madh është bashkëpunimi mes NJML-ve dhe pushtetit qendror. Ky tregues është vlerësuar me faktorin e rëndësisë 32%.

Vlera e këtij treguesi është ulur prej 0,72 në 2008 në 0,69 në vitin 2009. Vlerat mesatare gjegjëse të këtij treguesi janë 3,83 (2008) dhe 3,92 (2009).

Praktikisht, kjo do të thotë që pjesa më e madhe e komunave të analizuar në vitin 2008 dhe 2009, kanë marrë pëlqim për kërkesat e parashtruara në ministrinë gjegjëse, lidhur me aprovimin e dokumentacionit urban.

Treguesi 1.2: Liria në realizimin e ingjercës

Ky është treguesi i dytë që merr pjesë në formimin e nën-indeksit. Ky tregues ka faktor të rëndësisë 68% dhe është rezultat i mendimit të nëpunësve në sektorin e urbanizmit dhe kryetarëve të komunave, për ndikimin e pushtetit qendror në zbatimin e kësaj ingjercence, si dhe për rëndësinë e lirisë më të lartë në zbatimin e ingjercës, që sigurisht se sjell efektivitet dhe efikasitet më të lartë në punë.

Ky tregues ka mbajtur vlerë të njëjtë në dy vitet e analizuara (2008 dhe 2009) – 1,62. Nota mesatare e këtij treguesi është 2,00 (2008 dhe 2009).


Ky tregues është treguesi i vetëm që ka fituar vlerë në bazë të mendimeve të nëpunësve të punësuar në sektorin e urbanizmit dhe kryetarëve të komunave, për rëndësinë e nivelit të lirisë në realizimin e ingjercenceve. Duke i marrë parasysh rezultatet për rëndësinë që i jepet këtij treguesi në kuadër të nën-indeksit, vlera e këtij treguesi në dy vitet e analizuara (2008 dhe 2009) ka mbetur konstante. Vlera e notës së treguesit na tregon që komunat e kanë vlerësuar lirinë e realizimit të ingjercës me 2, në gradacionin prej 1 deri në 5.

3.3.3 Nën-indeksi i gjendjes financiare të komunave në fushën e urbanizmit

Ky nën-indeksi i referohet aftësisë financiare të komunave për implementimin e ingjercës në fushën e urbanizmit dhe planifikimit urban. Faktori i rëndësisë së këtij nën-indeksi është 31/100, që do të thotë se indeksi merr pjesë me 31% në vlerën totale të IPDU-së.

Grafiku në vijim i tregon faktorët gjegjës të rëndësisë për çdo tregues që e krijon këtë nën-indeksi.

Faktorët e peshës (rëndësisë) së treguesve në NI 2



Vtabela në vijim e tregon vlerën e këtij nën-indeksi dhe treguesve që e formojnë atë, si dhe notave mesatare për të gjitha komunat e analizuara për vitin 2008 dhe 2009. Më poshtë jepet edhe përshkrimi i detajuar i secilit tregues. Vlera e nën-indeksit është ulur prej 3,44 (2008) në 3,13 (2009).

2008			TREGUESI
NI 2	Vlera mesatare e treguesit	Nota mesatare e treguesit	
3,44	0,22	3,08	2.1 Aftësia financiare e komunës për implementimin e planeve urbane
	2.039	3,92	2.2 Të dalat kapitale të komunës për banor
	0,76	4,08	2.3 Aftësia financiare e komunës për hartimin e planit urban
	0,38	2,33	2.4 Kapaciteti i komunës për rrënimin e objekteve të ndërtuara pa leje

TREGUESI	2009		NI 2
